



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT PËR KRIME TË RËNDA
TIRANË

Nr.91 regj
datë 10.09.2018

Nr. 102 Vendimi
datë 23.11.2018

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë nga gjyqtarët:

Idriz	MULKURTI	- Kryesues
Albana	BOKSI	- Anëtare
Fehmi	PETKU	- Anëtar

Asistuar nga sekretare, Drita Raspopi në Tiranë, sot më datë 23.11.2018, në seancë gjyqësore publike, në përfundim të shqyrtimit të çeshtjes penale nr. 91 akti, që i përket:

KËRKUES: Prokuroia për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar në seancë nga prokurori i apelit, z.Bujar Sheshi.

KUNDËR TË PANDEHURVE:

1. I.L., i biri i [...] dhe i [...], i datëlindjes [...], lindur në [...] dhe banues në [...], me shtetësi shqiptare, me gjendje civile i divorcuar, me arsim të lartë, me gjendje gjyqësore i padënuar, me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, në mungesë në seancën datë 23.11.2018, mbrojtur nga Av.Alban Qafa, zgjedhur prej tij me deklaram, si dhe Av.Sokol Kepi caktuar kryesisht nga gjykata.

I AKUZUAR: Përveprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, më shumë se një herë (dy herë), parashikuar nga nenet 260, 50 gërmat “h” dhe “gj” të Kodit Penal dhe “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak” në banesë, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal.

2. E.L., i biri i [...] dhe i [...], i datëlindjes [...], lindur në [...] dhe banues në [...], me shtetësi shqiptare, me gjendje civile i martuar, me fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar, me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, mbrojtur nga Av.Arben Prenga, zgjedhur prej tij me deklaram, si dhe Av.Farie Osmani, caktuar kryesisht nga gjykata, Dhoma e Avokatisë Tiranë.

I AKUZUAR: Përveprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.

3. Sh.S., i biri i [...] dhe i [...], i datëlindjes [...], lindur në [...] dhe banues në [...], me shtetësi shqiptare, me gjendje civile i martuar, me arsim të lartë, me gjendje gjyqësore i padënuar, me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, mbrojtur nga Av.Mitër Muça, zgjedhur prej tij me deklaram, si dhe Av.Eralda Brahimasi, caktuar kryesisht nga gjykata, Dhoma e Avokatisë Tiranë.

I AKUZUAR: Përveprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, më shumë se një herë (dy herë), parashikuar nga nenet 245 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe neni 50 i Kodit Penal.

4. N.B., i biri i [...] dhe i [...], i datëlindjes [...], lindur dhe banues në [...], me shtetësi shqiptare, me gjendje civile i martuar, me arsim të mesëm, me gjendje gjyqësore i padënuar, me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, mbrojtur nga Av. Ilir Murati, zgjedhur prej tijsi dhe Av. Arben Peci, caktuar kryesisht nga gjykata, Dhoma e Avokatisë Tiranë.

IAKUZUAR: Për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.

5. Y.K., i biri i [...] dhe i [...], i datëlindjes [...], lindur dhe banues në [...], me adresë: Rruga “[...]”, me shtetësi shqiptare, me gjendje civile i martuar, me dy femijë, me arsim të lartë, me gjendje gjyqësore i padënuar, me masë sigurimi “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, mbrojtur nga Av. Beqar Kocaqi, zgjedhur prej tij me deklaram në seancë, si dhe Av. Pranvera Doçi, caktuar kryesisht nga gjykata, Dhoma e Avokatisë Tiranë.

IAKUZUAR: Për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, më shumë se një herë (dy herë), parashikuar nga nenet 245 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe neni 50 i Kodit Penal.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në përfundim të gjykimit me vendimin nr.79 datë 12.07.2018 ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit I.L., për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me pesë vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit I.L., për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me tre vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit I.L., për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me një vit e gjashtë muaj burgim.

Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit I.L. me shtatë vjet burgim.

Bazuar në nenet 30 pika 1 dhe 35/1 të Kodit Penal, caktimin si dënim plotësues “Heqja e së drejtës për të kryer funksione publike”, për një afat prej pesë vite.

Në zbatim të neneve 37/a dhe 37/b gërma “dh” të K.Pr.Penale, uljen e masës së dënimit prej shtatë vjetë në tre vjet burgim.

Vuajtja e dënimit do të bëhet në burg të sigurisë së zakonshme.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit E.L., për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me tre vjet burgim.

Vuajtja e dënimit do të bëhet në burg të sigurisë së zakonshme.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Sh.S., për veprën penale “Korrupsionit aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me tre vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Sh.S., për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me një vit e gjashtë muaj burgim.

Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit [...] me katër vjet burgim.

Vuajtja e dënimit do të bëhet në burg të sigurisë së zakonshme.

4. Deklarimin fajtor të të pandehurit N.B., për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me tre vjet burgim.

Vuajtja e dënimit do të bëhet në burg të sigurisë së zakonshme.

5. Deklarimin fajtor të të pandehurit Y.K., për veprën penale “Korrupsionit aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me tre vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Y.K., për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me një vit e gjashtë muaj burgim.

Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Y.K. me katër vjet burgim.

Vuajtja e dënimit do të bëhet në burg të sigurisë së zakonshme.

6. Provat materiale:

Një armë zjarri [...]dhe numër serie [...],[...] me [...] të pagoditur, [...], me kalibër [...] dhe numër serie [...], sekuestruar në banesën e të pandehurit I.L. (procesverbali i datës [...]), konfiskohen dhe kalohen në favor të shtetit.

CD-të që shoqërojnë informacionin e kompanive celulare, mbeten pjesë e fashikullit të gjykitimit.

7. Shpenzimet proceduriale të hetimeve paraprake dhe shpenzimet gjyqësore (sipas formularit bashkëngjitur), i ngarkohen solidarisht të pandehurve I.L., E.L., Sh.S., N.B., Y.K.

8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Ndaj vendimit nr.79 datë 12.07.2018 kanë ushtruar apel, pranë sekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, të pandehurit I.L., E.L., Sh.S., N.B., Y.K, nëpërmes përfaqësuesve ligjor të tyre, të cilët kanë parashtruar në ankimete tyre si më poshtë:

1.Për të pandehurin I.L., nëpërmes mbrojtësit av.Erion Laze, apel i depozituar me datë 30.07.2018, me nr.476 ankimi, duke parashtruar:

Vendimi i gjykatës është i padrejtë, përse i përket masës së denimi caktuar ndaj të pandehurit, jo vetëm për fakti që i pandehuri ka bashkëpunuar me drejtësinë, por edhe rrethanat lehtësuese që ekzistojnë në rastin konkret, të cilat janë të tilla që të çojnë në përjashtimin e tij nga dënimi, sepse i pandehuri nuk është person që paraqet rrezikshmëri shoqërore, përkundrazi është një person me arsim të lartë, i cili nuk ka qënë asnjëherë i dënuar e nuk është i përfshirë në aktivitete kriminale.

Niveli arsimor i tij, gjendja social ekonomike, rrethanat familjare i martuar me katër fëmijë, pendimi i thellë, sjellja korrekte e tij pas kryerjes së veprës, koha e vuajtur e denimit janë rrethana të cilat i kanë shërbyer në funksion të qëllimit parandalues e rehabilitues të denimit janë rrethana, të cilat në tërësinë e tyre të lidhura me statusin e tij si bashkëpunëtor i drejtësisë, duhej të vlerësoheshin me objektivitet nga gjykata përse i përket përjashtimin të tij nga denimi.

Denimi i caktuar nga Gjykata është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjitpenal, sepse gjykata në kundërshtim me nenin 403 e vijues rrëzoi kërkesën për gjykim të shkurtuar, të cilën kërkojmë ta rregullojë apeli.Gjykimi i zakonshëm nuk sollindryshimin e akuzës, çka tregon se gjykata në gjendjen që kanë qënë aktet i jepte zgjidhje çeshtjes pa cënuar dhënien e drejtësisë.

Në përfundim ka kërkuar: Ndryshimin e vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, caktimin e një denimi më të ulët, aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale dhe përjashtimin nga dënimi e të pandehurit në respektim të nenit 37 të K.Pr.Penale.

2.Për të pandehurin E.L., nëpërmes mbrojtësit av. Ardian Visha, apel i depozituar me datë 20.07.2018, me nr.442 ankimi, duke parashtruar:

Ndryshe nga çfarë është kallëzuar dhe pretenduar në nisje të procedimit penal në ngjarje të ndodhura më parë ku janë përfshirë drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ngjarja është reduktuar në një produkt të ri, në tenderin e datës 31.05.2016, ku fitues ka rezultuar subjekti “[...]”. Nga njëra anë prokuroria pretendon dakortësimin e mëparshëm të subjekteve konkures në këtë tender për fiktivitetin e tij, nga ana tjetër synohej krijimi i

kushteve të përshtatshme që njëri të shpallej fitues, kontribut solidar në mitën e pretenduar prej dy milion lekë, paçka përfitimit të tenderit nga njëri prej tyre. Çdo dakortësim tenderus për radhën e përfitimit, do të kishte një pagues mite të vetëm, përfituesin e drejtëpërdrejtë të atij tenderi.

Prokuroria jo vetëm e pretendon këtë marrëveshje ndërmjet përfaqësuesve të operatorëve, por me vetbësim pretendon dijen e drejtuesve të D.P.Burgjeve, [...] dhe [...]. Versioni i prokurorisë mbi ndodhjen e faktit penal është i palogjikshëm, pasi është larg mëndjes që individë e shoqëria përkatëse përfituese e një tenderimi me ves, të jetë pala më pak e interesuar për mbarëvjetjen e saj.

Tërësia e bisedave telefonike të përdorura si momente provuese nga prokuroria për të nxjerrë anën subjektive të të pandehurve, mbetet e pasens kur këto biseda provojnë sipas prokurorisë njëzet komunikime mes [...] dh [...]t, por asnjë komunikim mes [...] e [...], e sidomos mes [...] dhe [...]. Interpretimi i këtyre bisedave nuk lidh në mënyrë të qëndrueshme asnjë moment veprimi të secilit të pandehur dhe në tërësi veprimet e tyre. Vlera prej dy milion lekë e pretenduar si mitë nuk përbën 20% të vlerës tenderuese dhe biseda telefonike ku referon prokurorja nuk ka asnjë lidhje me veprimet apo mosveprimet e të pandehurit [...].

Bisedat e muajit prill nuk kanë asnjë relevancë në tenderin e datës 31.05.20128, dhe përgjimet pas kësaj date nuk kanë asnjë lidhje me këtë tender. Vërtetësia e deklarimeve të [...]t, pavarësisht se nuk prekin posaçërisht të pandehurin [...] pasi ndërmjet tyre nuk rezultojnë asnjë kontakt telefonik, elektronik apo fizik, mbetet një hipotezë e rrëzueshme.

Dëshimtarët e pyetur, deklarinet e vetë të pandehurve, bien ndesh me deklarinet e të pandehurit [...]. Asnjëri prej të pyeturve, përfshirë dhe rezultatet e përgjimit, nuk përfshijnë të pandehurin [...] në këtë akt korruptiv të prezumuar.

Mohimi i gjyqimit të shkurtuar ishte i padrejtë edhe pse prej tërësisë së akteve të grumbulluara, pafajësia e të pandehurit [...] ishte e qartë.

Në përfundim ka kërkuar: Prishjen e vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, duke ndryshuar vendimin e ndërmjetëm dhe pranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar mbi bazën e akteve konform nenit 403 e vijues të K.Pr.Penale.

Deklarimin e pafajshëm të shtetasit [...] për veprën penale të “Korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetëor”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 i K.Penal.

3. Për të pandehurin Sh.S., nëpërmes mbrojtësit Av. Mitër Muça, apel i depozituar me datë 24.07.2018, me nr.453 ankimi, duke parashtruar:

Vendimi i gjykatës është i padrejtë, sepse na është rrëzuar me pa të drejtë kërkesa për gjykim të shkurtuar. Në rastin tonë çështja mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, pasi edhe pse gjykata vijoi me gjykim të zakonshëm duke marrë prova këto nuk patën ndonjë vlerë, në këto kushte kërkoj prishjen e vendimit të ndërmjetëm për gjykimin e shkurtuar. Përsa i përket procedurës së prokurorimit të datës 31.05.2016, operatori i përfaqësuar nga [...] (N.B.Kurti shpk), nëpërmjet vetë atij ([...]) ka përgatitur dokumentat e nevojshme dhe e ka paraqitur përpara komisionit me qëllim për të fituar. Komisioni ka arritur në konkluzionin që duhet të kualifikohet në fazën e parë vetëm subjekti i përfaqësuar nga [...], “[...]” shpk, duke u skualifikuar operatorët e tjerë. Skualifikimi ka qenë i padrejtë, pasi dokumentacioni ka qenë i plotë dhe referohet në ligjin nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”. Për këtë arsye [...] ka debatuar dhe me anëtarët e komisionit, pavarësisht se nuk i është drejtuar gjykatës, lidhur me këtë procedurë për vetë natyrën e këtij tenderi. Dëshimtarët kanë deklaruar që procedura e prokurimit ka qenë e drejtë dhe se nuk kanë pasur asnjë ndërhyrje.

Përsa i përket komunikimeve telefonike me të pandehurin [...], ato kanë qenë të lidhura për një kontratë që subjekti “[...]” ka patur të lidhur me D.P.Burgjeve për furnizimin me gaz. Përpos, insistimi i [...]t për ta takuar, lidhet me faktin që [...] i kërkonte që të ndihmonte një të njohurin e tij, të quajtur [...] në punësimin e këtij të fundit nga [...].

Komunikimet telefonike me të pandehurit [...], [...], [...] kanë qenë për shkak të punës dhe marrëdhënieve të tyre, të furnizimit të subjekteve që ata përfaqësonin. Komunikimin që ka

patur [...] me shtetasit [...] dhe [...], ai u ka kërkuar që t'i paguajnë shtetasit [...] disa fatura të prapambetura, të papaguara.

Përsa i përket deklarimeve të të pandehurit [...], ai iu ka thënë vetë se, e ka bërë këtë deklaram në kushtet e nevojës së madhe, pasi nuk i ishte zëvendësuar masa e sigurimit “arrest në burg”. I pandehuri [...] nuk mban mend as vendin, as datën as orën kur i janë dhënë vlerat monetare, kjo pasi ai ka deklaruar para gjykatës dhe përpara oficerit të policisë gjyqësore rrethana të pavërteta dhe deklaramet e tij nuk duhet të merren në konsideratë nga gjykata. Ai duhet të procedohet për veprat penale të parashikuara nga nenet 305/b dhe 306 të Kodit Penal. Gjatë datës 31.05.2016, të pandehurit kanë qenë nën vëzhgim dhe nuk ka mundësi që të mos jenë pikasur, kur [...] paska marrë nga [...] vlerën prej dy milion lekë.

Përsa i përket faktit të dhënies nga ana e tij së bashku me të pandehurin [...] të një vlere monetare, lidhur me një procedurë, ku [...] ishte me cilësinë e kryetarit të komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave ushqimore, u shpreh se kjo akuzë bazohet vetëm në deklaramet e shtetasit [...], i cili deklaroi në seancë gjyqësore që i ka dhënë ato në kushte dhune dhe se ato nuk janë të vërteta. Përveç kësaj, [...] në fazën e hetimit lidhur me këtë procedurë, është shprehur: “...ai duhej t'ia ketë dhënë ..” (pra [...] duhet t'ia ketë dhënë [...]). Ngjarja është e pahetuar dhe e paprovuar dhe si e tillë nuk qëndron (shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 10.05.2018 dhe konkluzionet përfundimtare). I pandehuri [...] gjatë pyetjes së tij në seancë gjyqësore nuk ka pranuar të ketë marrë rryshfet nga kjo procedurë. Insistimi i të pandehurit [...] për të takuar të pandehurin [...] ka qenë në kuadër të ndihmës që i kërkonte [...] për të ndihmuar gjatë punës një shtetas të thirrur [...] nga [...]. Përsa i përket qëndrimit të bashkëpunëtorit të drejtësisë, kjo nuk tregon ekzistencën e kësaj veprë penale, por me pozitën e tij për të qenë dakort me çdo kërkesë të prokurorisë.

Komisioni i cili ka marrë në dorëzim mallrat ushqimorë në prezencë të tij nuk ka pasur pretendime për cilësinë e tyre, pasi [...] ka qenë korrekt dhe ka zbatuar me përpikmëri përmbushjen e detyrimit të furnizimit konform parametrave të kërkuara. Marrja në dorëzim e produkteve ushqimore është bërë pa praninë e përfaqësuesve, pra pa praninë e tij dhe të firmës fituese “[...]” shpk me administrator të pandehurin [...].

Në përfundim ka kërkuar: Prishjen e vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë në këtë mënyrë:

Ndryshimin e vendimit të mdërmjetëm të gjykatës, duke vendosur praimin e gjykimit të shkurtuar.

Prishjen e vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, dhe pushimin e çeshtjes bazuar në nenin 428/c të K.Pr.Penale.

Sipas parashikimit të nenit 388 germa “a” të K.Pr.Penale deklarimin e pafajshëm të ankuesit [...], pasi nuk provohet se fakti ekziston.

4. I pandehuri N.B., nëpërmes mbrojtëses av. Ilir Murati, apel i depozituar me datë 20.07.2018, me nr.443 ankimi, duke parashtruar:

Vendimi i gjykatës është një vendim tërësisht në kundërshtim me ligjin dhe provat e administruara gjatë gjykimit. Gjykata ka arritur në këtë konkluzion pa analizuar në tërësinë e tyre, provat e shqyrtuar në gjykim pa argumentuar vërtetësinë e tyre dhe fuqinë provuese të fajësisë së tyre.

Provat shkresore, nuk implikojnë të pandehurin [...]. Nga kqyrja e subjektit “[...]” shpk nuk është gjetur asgjë e kundraligjshme. Nga kqyrja e telefonit celularë nuk ka rezultuar asnjë e dhënë lidhur me veprën penale për të cilën ai akuzohet. Kontratat e datës 27.04.2016 dhe 31.05.2016 si dhe dokumentat që shoqërojnë këtë të fundit janë kontrata e akte të rregullta ligjërisht.

Lidhur me përgjimet, pasi mbahet një vlerësim mbi kontekstin e bisedave të të pandehurit [...] me të pandehurit [...] dhe [...], kundërshtohet lidhja që i bëhet këtyre bisedave lidhur me tenderin e datës [...]. Të pandehurit [...] dhe [...], përveç lidhjeve për shkak të aktivitetit tregtar, kanë dhe lidhje miqësore dhe kanë pasur biseda ndërmjet tyre, nuk del nga këto biseda asnjë e dhënë që të implikojë të pandehurin [...] në dhënie rryshfeti për funksionarë

të lartë. I pandehuri [...] ka qenë duke u interesuar vazhdimisht për tenderin e anuluar dhe ka biseduar dhe me pjesëmarrës të tjerë në këtë tender si [...] dhe [...], por asnjë nga komunikimet telefonike të të pandehurit [...] nuk implikon atë dhe të tjerët në veprime korruptive. Dhe më të pandehurin [...] i pandehuri [...] është njohur nga ana e aktivitetit tregtar dhe e kanë lënë të pinë kafe dhe përgjimi i kësaj natyre nuk provon asgjë. Në lidhje me shumën prej njëzet milion lekë, ia ka dhënë për të përmbushur detyrimet e furnizimit gjatë kohës që do të ishte në [...]

Ka pasur një detyrim prej [...] lekë ndaj shtetasit [...] dhe i ka thënë [...] it që nëse nga vlera prej njëzet milion i tepronin t'ia jepte këtë vlerë [...] lekë [...], pasi këtë shumë nuk ka mundur t'ia kalojë [...] një ditë para nisjes për në [...] nëpërmjet bankës, por e ka xhiruar nëpërmjet bankës në datat [...] ose [...] qershor 2016.

Nuk qëndron argumenti i prokurorisë se subjektet pjesëmarrës në tender e linin qëllimisht një dokument mangut në mënyrë që të shpalljes fituese njëri prej tyre, nëse do të qëndronte ky argument nuk mund të shpjegohet fakti që dhe i pandehuri [...] kishte mangësi në dokumentacion edhe pse ai duhet të ishte fituesi. Dëshmitarit [...], shpjegoi se, nëpërmjet punonjësve të tjerë të zyrave, anëtarët e komisionit, i kanë kërkuar [...] informacion për saktësim nëse mejt i ishte mjet frigoriferik ose jo dhe kjo për të qenë më të sigurt.

Gjykata bazohet në deklaratimet e të pandehurit [...], me statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, deklaratime të cilat janë të pabesueshme dhe kontradiktore. Ai këto deklaratime i ka dhënë shumë kohë pas arrestimit, ndërsa ka pasur mundësi të deklarojë përpara oficerit të policisë gjyqësore në momentin e arrestimit. Nga deklaratimet e [...] t, sikurse dhe nga përgjimet telefonike, nuk dalin të dhëna që [...] u të këtë komunikuar me [...] n dhe ti këtë premtuar vlera monetare kundrejt fitimit të tenderit, të cilin e ka fituar konform të gjitha rregullave.

Nuk ka asnjë provë direkte ose indirekte për të provuar akuzën në ngarkim të të pandehurit [...] dhe bashkëpunimin e tij me të pandehurit e tjerë.

Në përfundim ka kërkuar: Shpalljen e moskopetencës së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe dërgimin e çeshtjes për gjykim në gjykatën kompetente.

Prishjen e vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe pushimin e çeshtjes penale në ngarkim të pandehurit [...], për veprën penale "Korrupsioni aktiv i funksionarëve aktiv i funksionarëve të lartë ose të zgjedhurve vendorë", parashikar nga neni 245 e 25 të K.Penal.

5. Për të pandehurin Y.K., nëpërmes mbrojtësit av. Beqar Kocaqi, apel i depozituar me datë 25.07.2018, me nr.458 ankimi, duke parashtruar:

Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parës është i gabuar i pambështetur në ligj e prova.

Subjekti "[...]" shpk, ku i pandehuri ka qenë administrator në periudhën që lidhet me procedurën e tenderit të datës 31.05.2016 me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, nuk ka marrë pjesë në këtë procedurë konkurimi. Nuk ka pasur asnjë interes ligjor dhe material, lidhur me subjektin që do të konkuronte dhe do të fitonte. Dhe në procedurat e tjera që ka marrë pjesë, ka konkuruar në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme dhe nuk ka pasur kurrë marrëveshje me subjektet e tjera që konkuronin. Secili subjekt ka mbrojtur interesat e veta ekonomike.

I pandehuri [...] ka njohje dhe marrëdhënie korrekte me të pandehurit [...], [...] dhe [...]. Takimet e zhvilluara kanë qenë të rastësishme dhe çdo subjekt administronte vetë dokumentacionin ligjor për konkurim. Nuk ka përgjime ambientale të takimeve të tij me të pandehurit e tjerë në lokale apo dhe në çdo vend tjetër.

Lidhur me përgjimin e numrit të telefonit të të pandehurit, përgjimi nuk është provë, por mjet për kërkimin e provës si dhe nga bisedat telefonike nuk rezulton asgjë e kundraligjshme dhe aq më pak të provohet fakti që ai të këtë kryer veprime korruptive. Gjykata keqinterpretonte një bisedë telefonike të tijën dhe të të pandehurit [...], duke interpretuar se është paguar rryshfet prej [...] lekë. Shifrat një dhe dy në fakt lidhen me orën e takimit, pra në orën 1 apo në orën 2.

Njohjet me shtetasit [...] dhe [...] kanë qenë vetëm si drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe në asnjë rast nuk iu ka dhënë atyre vlera monetare për të fituar

në mënyrë të parregullt një tender. Me të pandehurin [...], nga bisedat e përgjuara rezultoi se ai nuk ka pasur njohje të afërt dhe se marrëdhëniet kanë qenë të ftohta, jo armiqësore, por as miqësi. Takimi që ka bërë i pandehuri [...] me të pandehurin [...] ka pasur si qëllim që [...] të punësonte një të afërm të [...] dhe [...] i është ndodhur rastësisht në këtë takim, takim ky që është i mbikqyrur nga shërbimet e policisë.

Megjithatë prokuroria e ka pasur nën hetim me metoda speciale të hetimit, atëherë të pandehurit do të ishin kapur në flagrancë, por i pandehuri [...] as ka kryer dhe as ka pasur dijeni për kryerjen e veprimeve korruptive.

Përsa i përket deklaratimeve të dhëna në fazën e hetimit nga i pandehuri [...], ato janë marrë nën efektin e dhunës dhe presionit psikologjik nga oficeri i policisë gjyqësore dhe prokurori i çështjes, duke iu thënë do të kalbesh në burg, nuk do ti shohësh fëmijët, prandaj, më vonë i pandehuri ka bërë një deklaratë noteriale, sipas të cilës ai ka deklaruar të vërtetën e ngjarjes, deklaratë të cilën e ka depozituar dhe në prokurori.

Malli është dorëzuar prej tij në përmbushje të kontratës që kishte me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve me artikuj të tillë si [...],[...]r, [...],[...] etj, ka qenë në përputhje me kriteret ligjore që parashikonte kontrata e funizimit, shoqëruar me faturë, certifikatë origjinale malli, fletë - analizë lëshuar nga [...] dhe për pasojë mungonte motivi dhe shkak për të cilin duhet të jepte rryshfet [...] anëtarëve të komisionit përfshirë dhe të pandehurin [...].n. Pretendimet e akuzës, bazuar vetëm në bisedat telefonike të cinguar ndërmjet të pandehurve [...], [...], [...] lidhur me këtë fakt rrëzohen plotësisht, nga deklaratimet e të pandehurit [...] në seancë gjyqësore, i cili ka pohuar se procedura e kolaudimit ka qenë e rregullt dhe ka mohuar marrjen e rryshfetit me qëllim favorizimin e shoqërisë “[...]” që ai ka përfaqësuar. Lidhur me këtë episod dëshmitarët [...] dhe [...], anëtare të komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave ushqimore me kryetar të pandehurin [...] provuan dhe vërtetuan se, nuk ka pasur asnjë parregullsi apo veprime korruptive lidhur me këtë procedurë. Nuk ka asnjë provë apo indicje që të provojë akuzat e ngritura nga prokuroria në ngarkim të të pandehurit [...], u kërkua deklarimi i pafajshëm i tij.

Gjykata të mbajë në konsideratë faktin që [...] është person i rregullt dhe korrekt në shoqëri; është përfaqësues i një komuniteti pranë Njësisë Bashkiake nr[...], vërtetuar me vërtetimin nr. ekstra protokoll datë [...], lëshuar nga kjo njësi; është i padënuar më parë; është prind i një fëmije të mitur, referuar certifikatës së zyrës së gjendjes civile [...]. Hetimi, por dhe gjykimi i kësaj çështje penale, i ka krijuar një situatë të rënduar psikologjike të të pandehurit dhe familjes së tij, pa pasur prova për përfshirjen e të pandehurit në afëra korruptive.

Kërkojmë nga gjykata në apel të merren në konsideratë, fakti që gjendja shëndetësore e nënës së të pandehurit është e rënduar, për shkak se vuan nga tensioni dhe probleme kardiake, të cilat dhe i kanë shkaktuar paralizë, dhe se kjo provohet me raportin mjeko-ligjor datë 29.05.2018, lëshuar nga polikli[...] nr[...], gjithashtu, dhe fakti se bashkëshortja vuan nga probleme shëndetësore depresive, provuar kjo me vlerësimin psikologjik datë 07.06.2018 lëshuar nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor nr. [...], ku sipas këtij akti rezultoi se shtetasja [...]vuan nga probleme depresive. Kjo shtetase ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme nga familjarët me qëllim mbajtjen në kontroll të gjendjes shëndetësore të saj, ku personi i vetëm që kujdeset për shëndetin e nënës dhe bashkëshortes është pikërisht i pandehuri [...].

Në përfundim ka kërkuar: Ndryshimin e vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe deklarimin e pafajshëm të të pandehurit [...].

GJYKATA E APELIT PËR KRIME TË RËNDA

Si, dëgjoji palët të cilat në përfundim kërkuan:

Prokurori: Lënien në fuqi të vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Mbrojtësi Av.Alban Oafa: Ndryshimin e vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, caktimin e një denimi më të ulët, aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale dhe përjashtimin nga dënimi e të pandehurit në respektim të nenit 37 të K.Pr.Penale.

Mbrojtësi Av.Sokol Kepi: Dakort me kolegun.

I pandehuri I.L.: Dakort me avokatin.

Mbrojtësi Av.Arben Prenga: Prishjen e vendimit Nr.79, datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

-Ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe pranimin e kërkesës së shtetasit E.L. për gjykim të shkurtuar mbi bazën e akteve, konform nenit 403 e vijues të K.Pr.Penale.

-Deklarimin e pafajshëm të shtetasit E.L., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetëror”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 e 25 i K.P.

-Në alternativë për shkaqe procedurale, le të shikojmë edhe moskompetencën e kësaj gjykate, dhe natyrisht dërgimin e akteve gjykatës kompetente, por kjo ngelet dytësore në logjikën tonë sepse procesi disi e ka lodhur dhe këtë shtetast dhe natyrisht kërkon një zgjidhje sa më imediate.

I pandehuri E.L.: Dakort me avokatin

Mbrojtësi Av.Miter Muçaj: Prishjen e vendimit Nr.79, datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, duke ndryshuar vendimene ndërmjetëm e vendosur pranimin e gjykimit të shkurtuar.

Prishjen e vendimit Nr.79, datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe bazuar në nenin 388 gërma “d” të K.Pr.Penale, duke deklaruar të pafajshëm të të përfaqësuarit prej meje, Sh.S. pasi në rastin konkret fakti nuk ekziston

I pandehuri Sh.S.: Kërkoj pafajësinë dhe rrëzimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë në ngarkim tim.

Mbrojtësi Av. Ilir Murati: 1-Shpalljen e moskompetencës së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën kompetente.

2-Prishjen e Vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit N.B., për veprën penale të “Korrupsionit aktiv e funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendor” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 245 dhe 25 të Kodit Penal

I pandehuri N.B.: Dakort me avokatin

Mbrojtësi Av.Beqar Kocaqi: Për kompetencën, themi që nuk është kompetente Gjykata për Krime të Rënda, por është Gjykata Shkallës së Parë Tiranë.

Ndryshimin e Vendimit Nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe deklarimin e pafajshëm të pandehurit Y.K.

Mbrojtësi Av. Pranvera Doci: Dakort me kolegun.

I pandehuri Y.K.: Dakort me avokatin.

Kolegji i këtij gjykimi, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, gjyqtarin Idriz Mulkurti, dhe shqyrtoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Se, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda është vënë në lëvizje, mbi bazën e ankimeve depozituar në sekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë nga ankuesit, të pandehurit I.L., E.L., Sh.S., N.B., Y.K., të cilët ka ushtruar apel, ndaj vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

I.Rrethanat procedurale.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, nëbazetë informacionit referues datë 29.01.2016 të Drejtorisë për Krimin Ekonomik e Financiar, për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetitka regjistruar procedimin penal nr.16 viti 2016, për veprat penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë“, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë“, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Sipas këtij informacioni, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve është zhvilluar një prokurim me negociim të drejtëpërdrejtë rreth datave 6 apo 7 janar 2016 me objekt furnizimin me produkte ushqimore të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë “[...]” shpk, me administrator shtetasin [...] dhe “[...]” shpk me administrator shtetasin [...]. Sipas informacionit, pjesëmarrja e këtyre dy subjekteve është rezultat i marrëveshjes paraprake të tyre dhe i operatorëve të tjerë ekonomikë “[...]” shpk; “[...]” shpk; “[...]” shpk.

Operatorët që nuk do të merrnin pjesë në tender do të punonin si nënkontraktorë të firmës që do të fitonte. Sipas informacionit, [...] dhe [...] iu kanë thënë përfaqësuesve të operatorëve të tjerë që duhet të paguanin secili nga [...] lekë për llogari të [...] të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Më urdhërin datë 16.04.2016, janë regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, përbri procedimit penal nr. 16/2016, si persona nën hetim shtetasit [...],[...], [...], për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë“, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. Referuar të dhënave të përfuara deri në këtë datë, dërgimin e parave tek zyrtarët e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve do ta bënte shtetasi [...].

Më urdhërin datë 08.07.2016, janë regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, përbri procedimit penal nr. 16/2016, si persona nën hetim shtetasit [...], për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe [...] për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë“, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Më datë 11.01.2017 nga prokuroria është vendosur ndarja e akteve të procedimit penal nr.16/2016 në aktet e procedimiti penal nr.16/1 të vitit 2017 dhe regjistrimin e procedimit penal nr. 16/1 të vitit 2017 për veprat penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë“, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë“, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Më datë 11.01.2017 është dërguar për gjykim çështja penale në ngarkim të të pandehurve [...], [...], [...], [...], [...], me akuzat e sipërcituara, pra procedimi penal nr. 16/2016. Ndërsa në kuadër të procedimit tjetër penal është hetuar ish Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve [...] dhe është paraqitur për gjykim pranë Gjykatës për Krime të Rënda, duke u akuzuar ai për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë“, parashikuar nga neni neni 260 i Kodit Penal.

Gjatë gjykimit në shkallë të parë mbrojtësit dhe të pandehurit, kanë kërkuar që të procedohet me gjykim të shkurtuar, pasiçështja mund të zgjidhej në gjendje që kanë qënë aktet. Gjykata në shkallë të parë ka rrëzuar kërkesën e të pandehurve për gjykim të shkurtuar, duke argumentuar se, nuk ishte e bindur që mund t’a përfundonte çështjen në gjendjen që ishin aktet, pasi e ka parë të nevojshmeqë provat ti nënshtrohen debatit gjyqësor e kontradiktoritetit.

Në konkluzionet përfundimtare në shkallë të parëprokuroria, lidhur me procedurën e tenderit datë 31.05.2016 si dhe atë të kolaudimit të mallrave që ka marrë [...], nga subjekti “[...]” shpk,ka kërkuar që i pandehuri [...] duhet të dënohet dyherë për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë“, parashikuar nga neni 260 i K.Penal, ku në rastin eprocedurës së tenderit datë 31.05.2016,nëbashkëpunimme bashkëpandehurin e gjykuar më vete, [...]. Po kështu dhe për të pandehurit [...] dhe [...], prokuroria ka kërkuar që ato të dënohen, dy herë për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë

shtetërorë” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të K. Penal, lidhur me procedurën e tenderit datë 31.05.2016, si dhe me procedurën e kolaudimit të mallrave që ka marrëDPB, nga subjekti “[...]” shpk. Në përfundim për të pandehurin [...] ka kërkuar që të pezullohet dënimi me burgin, kjo sipas nenit 59 të K.Penal, ndërsa për të pandehurin [...] ka kërkuar caktimin si dënim plotësues “Heqja e së drejtës për të kryer funksione publike”, për një afat prej pesë vite, kjo sipas neneve 30 pika 1 dhe 35/1 të Kodit Penal.

Ndodhur në kushtet, kur të pandehurve [...], [...] e [...] në konkluzionet përfundimtare u janë komunikuar rrethana rënduese, të cilat nuk ka qënë në kërkesën për gjykim, pra është saktësuar akuza, duke u kërkuar dënimi për secilin episod, dhe jo më shumë se njëherë siç ka qënë akuza, gjykata në zbatim të neneve 372, 373 e 376/1 të K.Pr.Penale këtyre të pandehurve, iu ka dhënë kohë të përshatshme për tu mbrojtur. Të pandehurit [...], [...] dhe [...] kanë ezauruar efektivisht mundësitë e një procesi kontradiktor gjatë debatit për çdo provë të marrë gjatë shqyrtimit gjyqësor, për secilin nga këto fakte.

Në përfundim Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.79 datë 12.07.2018 ka deklaruar fajtor e dënuar të pandehurit si më poshtë:

1.[...]n për veprat penale:

a.“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 260 e 25 të K.Penal, lidhur me procedurën e tenderit datë 31.05.2016, kjo kryer në bashkëpunim me bashkëpandehurin e gjykuar më vete, [...].

b.“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.Penal, lidhur me kolaudimine mallrave që ka marrë DPB, nga nga subjekti “[...]” shpk.

c.“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal.

d. Bazuar në nenet 30 pika 1 dhe 35/1 të Kodit Penal, caktimin si dënim plotësues “Heqja e së drejtës për të kryer funksione publike”, për një afat prej pesë vite.

2.[...] për veprën penale: “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të K.Penal, lidhur me procedurën e tenderit datë 31.05.2016.

3.[...] për veprat penale:

a.“Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të K.Penal, lidhur me procedurën e tenderit datë 31.05.2016.

b.“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 244 e 25 të K.Penal, lidhur me kolaudimine mallrave që ka marrë DPB, nga nga subjekti “[...]” shpk.

4.[...] për veprën penale: “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të K.Penal, lidhur me procedurën e tenderit datë 31.05.2016.

5.[...] për veprat penale:

a.“Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të K.Penal, lidhur me procedurën e tenderit datë 31.05.2016.

b.“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 244 e 25 të K.Penal, lidhur me kolaudimine mallrave që ka marrë DPB, nga nga subjekti “[...]” shpk.

Ndaj vendimit nr.79 datë 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, kanë ushtruar ankim brenda afatit ligjor, të pandehurit, ankim i cili është objekt gjykimi në apel.

Gjatë gjykimit në apel, mbrojtësit e tëpandehurve kërkuar që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor, sepse janë vënë në dijeni se, pasi është dhënë vendimi në shkallë të parë, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr.70 datë 19.9.2018ka deklaruar të pafajshëm bashkëpandehurine gjykuar më vete, [...], për veprën penal “Korrupsioni pasiv i funksionarëve

të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 260 e 25 të K.Penal, lidhur me procedurën e tenderit datë 31.05.2016, kjo e kryer në bashkëpunim me të pandehurin e këtij gjykimi [...], prandaj kanë kërkuar që ky vendim që është formës së prerë duhet të administorhet në apel, dhe të bëhet pjesë e fashikullit të gjykimit.

Kolegji, ndodhur para një fakti të tillë pranoi kërkesën e mbrojtjes, pasi kjo, gjen mbështetje në nenin 427/2 të K.Pr.Penale në të cilin theksohet: “1. Kur një palë në aktin e apelit ose plotësimin e tij, kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata në qoftë se çmon se nuk mund të vendosë në gjendjen që janë aktet, përsërit shqyrtimin gjyqësor. 2. Për provat që zbulohen pas gjykimit të shkallës së parë ose të atyre që dalin aty për aty, gjykata vendos, sipas rastit, marrjen ose jo të tyre. Më pas u është dhënë kohë palëve për tupërgatitur, në kushtet kur në apel u administruar një provë e re që ishte vendimi nr.70 datë 19.09.2018 i Gjykatës së Apelit.

Pas administrimit të vendimit të sipërcituar nga mbrojtësit u paraqit kërkesa për shpalljen e moskopesës për gjykimin e kësaj çështje me arsyetimin se, në kushtet kur është shpallur i pafajshëm zyrtari i lartë, tashmë bie akuza e nenit 260 të K.Pr.Penale, gjë që e bën inkopetente Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Po kështu i pandehuri [...] dhe mbrojtësi i tij kërkuar që të pyeten dhe dy dëshmitarë me pretendimin se, ato i kanë kërkuar dhe gjatë gjykimit në shkallë të parë, por nuk u janë pranuar.

Kolegji, duke i konsideruar si të panevojshme provat e kërkuar nga i pandehuri [...] dhe mbrojtësi i tij, Muça, ka refuzuar kërkesën për riçelje të shqyrtimit gjyqësor, aq më tepër kur ka kaluar momenti procedural, kjo në respektim të nenin 427/1 të K.Pr.Penale, ndërkohë kolegji vlerëson të shprehet se, kërkesa për shpalljen e moskopesës, ka qënë e padrejtë dhe e pa mbështetur në lig, pasi kjo gjykatë ka gjetur veten kopetente, sepse jemi përpara një ankimi, ndaj një vendimi të gjykatës së shkallës së parë, e cila ka qënë kopetente për gjykimin e çështjes, kjo në referim të neneve 75/a shkronja “a” dhe 525/1 të K.Pr.Penale.

II. Rrethanat e faktit penal, të provuara gjatë gjykimit në shkallë të parë e apel.

Bazuar në aktet dhe provat e shqyrtuara, gjatë gjykimit në shkallë të parë kanë rezultuar të provuara këto rrethana fakti.

a. Për episodin, lidhur me tenderin datë 31.05.2018.

Të pandehurit, [...], [...], [...] dhe [...], pasi kanë rënë në dijeni për anulimin e procedurës së prokurimit me shpallje paraprake nga Agjencia e Prokurimit Publik, procedurë në të cilën kishin marrë pjesë vetëm dy subjekte, njëri prej tyre ai i përfaqësuar nga i pandehuri [...], “[...]” shpk, nga data 23.05.2016 e në vijim, kanë filluar përpjekjet për tu lidhur me drejtuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kryesisht me ish zëvendës drejtorin [...].

Të pandehurit [...] dhe [...] kanë kontaktuar dhe janë takuar me zëvendës drejtorin e përgjithshëm të burgjeve, të pandehurin [...]. I pandehuri [...] i ka bërë të qartë të pandehurit [...] që lidhjet për këtë procedurë do ti mbante me [...], të pandehurin [...]. Sipas, të pandehurit [...], nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve kishte marrë porosi që, për këtë procedurë, e cila do të bëhej pa shpallje paraprake të kontratës për shkaqe të urgjencës, ai do të mbante kontakte me të pandehurin [...], i cili kishte dalë garant për dhënien e një shpërblimi prej afërsisht 10% të vlerës së tenderit.

Të pandehurit [...], [...], [...] dhe [...] janë marrë vesh paraprakisht se, si duhet të përgatiteshin në dorëzimin e dokumentacionit të pjesëmarrjes në këtë tender, në mënyrë të tillë që të shpallnin fitues ndonjërin prej tyre, dhe konkretisht subjektin e përfaqësuar nga i pandehuri [...], “[...]” shpk, i cili ishte dhe subjekti, mbi ankimin e të cilit ishte anuluar e gjithë procedura me shpallje elektronike dhe për efekt të këtij anulimi lindte nevoja për zhvillimin e procedurës pa shpallje paraprake. Në vijim, subjektet tregtare të përfaqësuar nga të pandehurit [...], [...] dhe [...] do të kishin përfitimin e tyre ekonomik, duke dalë në rolin e nënkontraktorit në furnizimet që do kryheshin nga subjekti fitues “[...]” shpk.

Për veprimet e të pandehurve [...], [...], [...] dhe [...], të kryera në emër të shoqërive tregtare që ata përfaqësonin, ishte në dijeni paraprakisht zëvendës drejtori i përgjithshëm i

burgjeve, të cilit i ishte garantuar nga i pandehuri [...] dhënia e një përfitimi të parregullt prej dy milion lekë, që do të mblidhej nga përfaqësuesit e operatorëve.

I pandehuri [...], ka marrë nga i pandehuri [...] përfitimin e parregullt monetar, vlerën prej dy milion lekë, vlerë kjo e mbledhur dhe nga të pandehurit e tjerë. Marrëveshja për dhënien e kësaj vlere nga të pandehurit [...], [...], [...] dhe [...] si dhe për marrjen e kësaj vlere nga [...], ka qenë më e hershme sesa data e zhvillimit të tenderit, 31.05.2017.

b. Episodi, lidhur me kolaudimine mallrave që ka marrë DPB, nga nga subjekti “[...]” shpk, sipas kontratës nr. 7/5 datë 20.04.2016.

Operatori ekonomik “[...]” shpk me administator të pandehurin [...] ka lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve kontratën nr. 7/5 datë 20.04.2016 “Blerje ushqimi bazë”. Në zbatim të kësaj kontratë dhe legjislacionit në fuqi, me urdhërin nr. 107 datën 09.05.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, [...], është ngritur grupi i marrjes në dorëzim të artikujve ushqimorë mbi bazën e kësaj kontrate, me detyra: kolaudimin e artikujve ushqimorë; raportimin mbi fazat e zhvillimit të kolaudimit; përgatitjen e procesverbalit të marrjes në dorëzim në rastin e pranimit të artikujve të furnizuar, ose të një materiali shkresor në rastin e refuzimit të artikujve. Komisioni, përbëhej nga kryetari [...] dhe anëtarë dëshmiatret [...]e [...].

Më të njëjtin datë, pra 09.05.2016, me një urdhër të dytë, drejtori i është drejtuar sektorit të shërbimeve dhe projekteve në Insitutucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale [...]dhe [...], duke urdhëruar magazinimin e artikujve në magazinat e këtyre institucioneve. Po me një urdhër të kësaj date, është njoftuar operatori “[...]” shpk me administator të pandehurin [...], për magazinimin e sasive përkatëse në IEVP-të [...]dhe [...] si dhe fakti që kolaudimi i mallit dhe marrja në dorëzim do të bëhet nga komisioni përkatës i D.P.Burgjeve dhe se do të bëhet hyrje në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve kundrejt faturës tatimore të furnitorit dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim.

Pesë ditë më vonë, më datë 16.05.2016, rezulton që komisioni, me kryetar të tij të pandehurin [...], të ketë marrë mostër nga artikujt e furnizuar dhe magazinuar në magazinat e D.P.Burgjeve në [...], [...]dhe [...], me qëllim dërgimin në laboratorin përkatës për të kryer verifikimin e treguesve cilësorë të mallit.

Më datë 20.05.2016 grupi i kolaudimit me kryetar të pandehurin [...], nëpërmjet procesverbalit përkatës, kanë marrë në dorëzim mallrat, duke arsyetuar se plotësojnë treguesit sipas specifikimeve teknike dhe kontratës, duke vendosur që malli të bëhej hyrje në magazinë.

Më datë 23.05.2016, kryetari i komisionit, i pandehuri [...], nëpërmjet një memoje, i është drejtuar drejtorit [...], duke e vënë në dijeni të procedurës së marrjes në dorëzim, duke sqaruar se malli shoqërohet me faturë tatimore të datës 10.05.2016.

Drejtori [...], po në këtë datë e ka miratur, duke shënuar në këtë dokument shkruar me dorë: “*Dakort me relatimin e komisionit. Të ndiqen procedurat e mëtejshme ligjore*”. Po në këtë datë, mallrat janë bërë hyrje në magazina, referuar fletës së magazinimit nr.11 datë 23.05.2016.

I pandehuri [...], gjatë përmbushjes dhe për shkak të detyrës së anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave ushqimore në zbatim të kontratën nr.7/5 datë 20.04.2016 “Blerje ushqimi bazë”, ka kërkuar nga përfaqësuesi i subjektit “[...]”, i pandehuri [...], si dhe nga përfaqësuesi i subjektit “[...]”, i pandehuri [...], që luante rolin e furnizuesit të mallit për llogari të subjektit “[...]”, një përfitim të parregullt [...]lekë. Marrëveshjen për dhënien e këtij përfitimi është bërë me të pandehurin [...], ku ky i fundit në marrëveshje me të pandehurin [...] i kanë dhënë të pandehurit [...] shumën e kërkuar.

Rrethana të tilla të fakti janë provuar, me provat dhe aktet që po i citojmë më poshtë:

A. Provat dhe shkresore:

1.Vendim datë 29.01.2016 për regjistrimin e procedimit penal, nr.16/2016, për veprat penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”,

parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

2.Urdhër datë 16.04.2016, për regjistrimin si persona nën hetim shtetasit [...], [...], [...], për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 e 25 i Kodit Penal.

3.Urdhër datë 08.07.2016, për regjistrimin si persona nën hetim tështetasit [...], për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 e 25 të Kodit Penal si dhe [...] për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

4.Vendim, për zgjatjen e afatit hetimor, datë 07.10.2016, për një periudhë një mujore, nga data 08.10.2016 deri në datë 08.11.2016 ndaj personave nën hetim [...] dhe [...].

5.Vendim për zgjatjen e afatit hetimor, datë 15.07.2016, për një periudhë tre mujore, nga data 16.07.2016 deri në datë 16.10.2016, ndaj personave nën hetim [...], [...] dhe [...].

6.Vendim për zgjatjen e afatit hetimor, datë 07.10.2016, për një periudhë një mujore, nga data 08.10.2016 deri në datë 08.11.2016, ndaj personit nën hetim [...].

7.Vendim për zgjatjen e afatit hetimor, datë 14.10.2016, për një periudhë dy mujore, nga data 16.10.2016 deri në datë 16.12.2016, ndaj personave nën hetim [...], [...] dhe [...].

8.Vendim për zgjatjen e afatit hetimor, datë 07.11.2016, për një periudhë një mujore, nga data 08.11.2016 deri në datë 08.12.2016, ndaj personave nën hetim [...] dhe [...].

9.Vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve, datë 07.12.2016, për një periudhë dy mujore, nga data 08.12.2016 deri në datë 08.02.2017 ndaj personave nën hetim [...] dhe [...].

10.Vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve, datë 15.12.2016, për një periudhë dy mujore, nga data 16.12.2016 deri në datë 16.02.2017, ndaj personave nën hetim [...], [...] dhe [...].

11.Procesverbal datë 29.01.2016, për kqyrjen e të dhënave nga interneti, faqja e Q.K.R-së, ku rezulton të jenë kqyrur të dhënat e subjektit “[...]” sh.p.k, me numër [...] dhe datë themelimi 04.01.1999. Objekti i veprimtarisë rezulton të jetë: Tregtim i artikujve të ndryshëm ushqimorë, industrialë, restorant, hoteleri, prodhim, tregtim i lëndës së parë ushqimore dhe shpërndarjes së saj, në fushën e ndërtimeve etj.

12.Procesverbal datë 29.01.2016 për kqyrjen e të dhënave nga interneti, faqja e Q.K.R-së, ku rezulton të jenë kërkuar, duke u mbajtur një procesverbal për subjektet “[...]” sh.p.k, “[...]” sh.p.k, “[...]” sh.p.k, “[...]” sh.p.k.

13.Procesverbal datë 28.06.2016, për kqyrjen e të dhënave nga interneti, faqja e Q.K.R-së, ku rezulton të jenë kqyrur të dhënat e subjektit “[...]” sh.p.k, me numër NIPTI [...] dhe datë themelimi 25.03.2005. Objekti i veprimtarisë rezulton të jetë: import eksport me shumicë e pakicë i mallrave, prodhim i materialeve ushqimorë, industrialë etj. Përsa i përket ortakëve rezulton që ortak i vetëm dhe administrator është [...].

14.Procesverbal datë 28.06.2016, për kqyrjen e të dhënave nga interneti, faqja e Q.K.R-së, ku rezulton të jenë kqyrur të dhënat e subjektit “[...]” sh.p.k, me numër NIPTI [...] dhe datë themelimi 10.02.1995. Objekti i veprimtarisë rezulton të jetë: tregtim me shumicë e pakicë i artikujve të ndryshëm industrialë, tregtim me shumicë e pakicë i produkteve me origjinë shtazore për njerëz etj. Përsa i përket ortakëve rezulton që ortak i vetëm dhe administrator është [...].

15.Procesverbal datë 28.06.2016, për kqyrjen e të dhënave nga interneti, faqja e Q.K.R-së, ku rezulton të jenë kqyrur të dhënat e subjektit “[...]” sh.p.k, me numër NIPTI [...] dhe datë themelimi 23.02.1996. Objekti i veprimtarisë rezulton të jetë: prodhim brumërash si bukë e prodhime të tjera të kësaj natyre, import eksport drithërash për bukë etj. Përsa i përket ortakëve rezulton që ortak i vetëm dhe administrator është [...].

16.Procesverbale datë 28.06.2016, për kqyrjen e të dhënave nga interneti, faqja e Q.K.R-së, ku rezulton të jenë kqyrur të dhënat e subjektit “Kadra” sh.p.k, me numër NIPTI [...] dhe datë themelimi 27.08.1993 me ortak të vetëm dhe administrator [...].

17.Procesverbal datë 28.06.2016,për kqyrjen e të dhënave nga interneti, faqja e Q.K.R-së, ku rezulton të jenë kqyrur të dhënat e subjektit “[...]” sh.p.k, me numër NIPTI [...] dhe datë regjistrimi 17.03.1999 me ortak të vetëm dhe administrator [...].

18.Procesverbal datë 29.01.2016,për kqyrjen e të dhënave kompjuterike në sistemin TIMS, ku rezulton të jenë kërkuar të dhëna për shtetasit [...], [...], [...].

19.Procesverbal datë 11.07.2016 për kontrollin e vendeve, konkretisht banesa e shtetasit Teodor Labi, i ati i të pandehurit [...], e ndodhur në qytetin e [...]. Nga kontrolli i banesës nuk janë gjetur sende të paligjshme.

20.Procesverbal datë 11.07.2016 për kontrollin e vendeve, konkretisht banesa e pandehurit [...], e ndodhur në qytetin e [...] rruga “[...]”, shoqëruar me vendimin datë 13.07.2016 të prokurorit,për vleftësimin e kontrollit të banesës. Në banesë, në garderobën e dhomës së gjumit, janë gjetur të futura në një [...]nëntë [...], ndërsa poshtë dyshekut të krevatit dopio të dhomës së gjumit është gjetur një [...]. Ngjitur me armën është gjetur një [...]të pagoditur.Ky procesverbal është shoqëruar dhe me tabelën fotografike, ku fiksohen provat materiale të gjetura.

21.Procesverbal datë 11.07.2016 për sekuestrimin e provave materiale, shoqëruar me vendimin e prokurorit datë 13.07.2016, ku i janë sekuestruar të pandehurit [...] një armë zjarri e markës [...] kalibër [...]mm me numër serie [...], një [...]m të pagoditur; nëntë [...].

22.Akti i ekspertimit teknik i armëve dhe fishekëve të sekuestruara në banesën e të pandehurit [...], nr.6405, datë 15.07.2016 që ka këtë konkluzion:

a. [...], klasifikohet në armë zjarri luftarake pistoletë [...]dhe në gjendjen që na paraqitet është e rregullt teknikisht dhe e përshtatshme për qitje.

b. [...]objekt ekspertimi u përkasin [...]që përdoren nga [...] të tjera të këtij kalibri, si dhe [...].

c.Nëntë [...] e tjerë u përkasin fishekëve standard luftarak, kalibër [...]mm që përdoren si municion për armët e kalibrit si pistoletë beretta 11.43 mm, pushkët rington, automatikët MP40 dhe të ngjashmet me to.

d.Gjithë fishekët objekt ekspertimi janë të rregullt teknikisht dhe të përshtatshëm për qitje.

e. [...], të fiksuara në ngjarje të ndodhura më parë në territorin e Republikës së [...] dhe të regjistruara në sistemin informatik “[...]” deri në datën 01.07.2016 nuk janë qitur nga arma objekt ekspertimi me Nr. [...].

23.Procesverbal datë 11.07.2016për sekuestrimin e provave materiale, shoqëruar mevendimin e prokurorit datë 13.07.2016, ku është sekuestruar aparati celular i të hetuarit [...] i markës “[...]” me numër të vënë [...].

24.Procesverbal datë 11.07.2016 për kontrollin e vendeve”, konkretisht banesa e shtetasit [...], e ndodhur në qytetin e [...]. Nga kontrolli i banesës nuk janë gjetur sende të paligjshme.

25.Procesverbal datë 11.07.2016 për kontrollin e vendeve”, konkretisht banesa e shtetasit [...], e ndodhur në qytetin e [...], shoqëruar me vendimin datë 13.07.2016 të prokurorit për vleftësimin e kontrollit të banesës. Nga kontrolli i banesës nuk janë gjetur sende të paligjshme.

26.Procesverbal datë 11.07.2016 për kontrollin e vendeve, konkretisht banesa e shtetasit [...] [...], specialist i teknologjisë së informacionit në shoqërinë “[...]” SH.P.K, ndodhur në qytetin e [...], shoqëruar me vendimin datë 13.07.2016 të prokurorit për vleftësimin e kontrollit të banesës. Nga kontrolli i banesës janë gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provave materiale, procesverbal për kqyrjen dhe marrjen e provave materiale, tetë vula të disa subjekteve tregtare, përfshirë dhe vulat e subjekteve, “[...]“ sh.p.k, “[...]” sh.p.k, “[...]” sh.p.k, “[...]” sh.p.k. Sekuestrimi i kryer nga policia gjyqësore është vleftësuar nga prokurori me vendimin datë 13.07.2016.

27.Procesverbal datë 11.07.2016 për marrjen e dokumentave, ku është marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dorëzuar nga [...], struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

28.Procesverbal datë 05.12.2016 për marrjen e modeleve të vulave, sekuestruar shtetasit [...], vula të subjekteve, shoqërive me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k): “[...]”; “[...]”; “[...]” SH.P.K; “[...]”; “[...]”; “[...]”.

29.Shkresën nr.5555/1, datë 21.12.2016 [...], me informon lidhur me numrat e telefonit të shtetasve [...], [...] dhe [...] për periudhën kohore 01.12.2015-31.07.2016, bashkëngjitur dhe praktikat e abonimit.

30.Në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Prokuroria për Krime të Rënda, shkresën nr.6418/1, datë 21.09.2016 e “[...]” sh.a, me informon lidhur me numrin e telefonit që ka të regjistruar shtetasi [...], [...], numër në fillim në emër të shoqërisë “[...]” dhe më tej kaluar në emër të tij.

31.Të dhënat në formë elektronike datë 13.09.2016 përcjellë nga “[...]” sh.a, lidhur me numrat në përdorim të shtetasve [...], [...], [...], [...], [...]. por që asnjëri prej tyre nuk paraqet interes në kuadër të këtij gjykimi.

32.Procesverbal datë 11.07.2016 për sekuestrimin e provave materiale, shoqëruar me vendimin e prokurorit datë 13.07.2016, ku rezulton se është sekuestruar aparati celular i të hetuarit [...] i markës “[...]” me IMEI [...] me numër të vënë [...].

33.Procesverbal datë 19.07.2016 për kqyrjen e sendeve, konkretisht rezulton të jetë kqyruar telefoni celular që i është sekuestruar të pandehurit [...], i markës “[...]” me IMEI me numër të vënë [...]. Janë gjetur të dhëna të përfuara me interes për hetimin në aplikacionin “[...]”, me shtetasin, numri i telefonit është shënuar me emrin “[...]” AMC.

Bisedë datën 10.05.2016, ora 10.54 me përmbajtje: [...]

Bisedë datë 06.01.2016, ora 18.54, me numrin e kontaktit “[...]”. Nga ky i fundit janë dërguar dy praktika formularë oferte të subjektit “[...]” sh.p.k dhe përgjigjia e [...] Kalasë[...].

34.Procesverbal datë 19.07.2016 për kthimin e sendeve.

35.Procesverbal datë 11.07.2016 për sekuestrimin e provave materiale, shoqëruar me vendimin e prokurorit datë 13.07.2016, është sekuestruar aparati celular i të hetuarit [...] i markës “[...]” me numër të vënë [...].

36.Procesverbal datë 19.07.2016 për kqyrjen e sendeve, konkretisht rezulton të jetë kqyruar telefoni celular që i është sekuestruar të pandehurit [...], i markës “[...]” me numër të vënë në përdorim [...], ku nuk ka rezultuar të dhëna me interes.

37.Procesverbal datë 16.09.2016 për kthimin e sendeve.

38.Procesverbal datë 11.07.2016 për sekuestrimin e provave materiale, shoqëruar me vendimin e prokurorit datë 13.07.2016, ku është sekuestruar aparati celular i të hetuarit [...] i markës “[...]” me numër të vënë [...].

39.Procesverbal datë 11.07.2016 për sekuestrimin e provave materiale, shoqëruar me vendimin e prokurorit datë 13.07.2016, ku është sekuestruar aparati celular i të hetuarit [...] i markës “Samsung” me IMEI [...] me numër të vënë [...].

40.Dokumente nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, marë sipas vendimit të prokurorit për sekuestrim dokumentacioni, datë 07.06.2016 dhe procesverbalit datë 28.06.2016, praktikat dokumentare të disa tenderave, kontrata e lidhur më datë 05.01.2016 e në vijim. Në fashikullin e gjykimit dhe pjesë e provave dokumentare të pranuar për shqyrtim është vetëm praktika e prokurimit të finalizuar me kontratën nr.27/5, datë 31.05.2016, lidhur me operatorin ekonomik “[...]” SH.P.K për blerje [...] dhe [...]

41. Memo, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, [...] i përgatitur nga sektori i prokurimeve, shtetasit [...] dhe [...] datë 25.05.2016, me objekt: Mbi argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit “Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për “[...]” deri në realizimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”.

42.Urdhëri nr.114 prot, datë 26.05.2016 i titullarit të autoritetit kontraktues [...], për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit për “Blerje bulmet dhe vezë, komision i përbërë nga kryetare Irisi Et’hemaj, anëtarë [...], [...].

43.Memo pa numër protokolli, por mban datën 26.05.2016. Rezulton të jetë një akt ku komisioni i përcaktimit të fondit limit të ushqimeve, [...] dhe bumet, përbërë nga [...], [...]dhe [...], i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, [...], nëpërmjet zëvendës drejtorit të Përgjithshëm [...]. Në përfundim të përlllogaritjeve komisioni i fondit limit ka vendosur të marrë për bazë alternativën me fond 18.883.800 lekë pa TVSH dhe vlerën 22.660.560 lekë me TVSH.Në këtë akt rezulton të jetë bërë shënimi me shkrim dore nga drejtori [...],[...]a e [...], dakort me reklaminin e komisionit, të ndiqen procedurat e mëtejshme ligjore 26.05.2016.

44.Kontratë nr.20/4 datë 27.04.2016, lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, përfaqësuar nga drejtori [...]dhe operatorit ekonomik “[...]” sh.p.k. Kjo është kontrata, afati i së cilës rezulton të përfundojë më datë 27.05.2016, sqaruar ky moment dhe në aktin Memo, datë 25.05.2016, fq.2 e aktit, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nga sektori i Prokurimeve.

45.Formular i njoftimit të kontratës nr.27/1, datë 27.05.2016,sipas këtij akti të titullarit të autoritetit kontraktues [...]shpallet procedura e prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” me objekt “[...]” me fond limit [...]me afat 80 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Sqarohet në këtë akt se hapja e ofertave do të bëhet më datë 31.05.2016, ora 14.00 në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

46.Dokumentat e nënshkruara nga titullari i autoritetit kontraktues, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve [...]me nr.27/2, datë 27.05.2016 të emërtuar “Ftesë për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit negociom pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt “[...]” drejtuar operatorëve ekonomik, “[...]” sh.p.k; “[...]” sh.p.k; Bashkimi i Operatorëve “[...]” sh.p.k; “[...]” sh.p.k; “[...]” sh.p.k; “[...]” sh.p.k.

47.Dokumenti “[...]” datë 27.05.2016 drejtuar drejtuesit [...]nga sektori i prokurimeve: [...], [...]dhe [...], ku propozohet përberja e komisionit të vlerësimit të ofertave, kryetar [...], anëtar [...], [...]. Ky akt pasohet me urdhërin nr.27/3, datë 30.05.2016 të titullarit të autoritetit kontraktor, [...]për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, me anëtarët e propozuar.

48.Tre formularë deklarimi të anëtarëve të komisionit [...], [...], [...], për mosqënien në kushtet e konfliktit të interesit.

49.Dokumenti procesverbal nr.1, Hartimi dhe miratimi i dokumentave standartë të tenderit për procedurën e prokurimit,blerje [...]. Akti është nënshkruar nga komisioni i hartimit të dokumentave, [...], [...], [...].

50.Tre formularë deklarimi të anëtarëve të komisionit [...], [...], [...], për mosqënien në kushtet e konfliktit të interesit.

51.Procesverbal datë 31.05.2016, faza I, i hartuar nga anëtarët e komisionit të hartimit të dokumentave standartë të tenderit [...], [...], [...],vlerësimin e dokumentacionit ligjor, teknik dhe ekonomik-financiar. Rezulton të jetë kualifikuar vetëm subjekti “[...]” SH.P.K dhe janë skualifikuar operatorët e tjerë ekonomik “[...]” sh.p.k; “[...]” sh.p.k; Bashkimi i Operatorëve “[...]” sh.p.k; “[...]” sh.p.k; “[...]” sh.p.k.

52.Procesverbal datë 31.05.2016, Faza II, i hartuar nga antarët e komisionit, [...], [...], [...],vlerësimi i ofertave ekonomike, ku komisioni ka vendosur të shpallë fitues operatorin ekonomik, “[...]” sh.p.k.

53.Raport përfundimtar mbi procedurën e prokurimit negociom pa shpallje paraprake të objektit nr.27/4 prot. datë 31.05.2016, i emërtuar, Blerje bulmet dhe vezë, përgatitur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kryetar[...], antëtar [...], [...]. Referuar këtij dokumenti, raporti i përcillet drejtuesit të autoritetit kontraktor, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Z.[...].

54.Kontrata nr.27/5, datë 31.05.2016 e lidhur ndërmjet autoritet kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, përfaqësuar nga drejtori [...]dhe operatorit ekonomik “[...]” shpk.

55.Praktikat dokumentare e marrjes në dorëzim të ushqimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në bazë të urdhërit nr.107, datë 09.05.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ku janë marrë me cilësinë e provave “dokument” nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, referuar vendimit të prokurorit “Për sekuestrim dokumentacioni”, datë 02.09.2016 dhe procesverbalit datë 06.09.2016.

56.Urdhër shpenzimi nr.206, datë 14.06.2016, urdhërues Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për subjektin “[...]” sh.p.k në vlerë 25.045.596 si dhe faturë tatimore shitje lëshuar nga subjekti “[...]” sh.p.k, përfaqësues [...].

57.Urdhër nr.107, datë 09.05.2016 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për ngritjen e grupit të marrjes në dorëzim të artikujve ushqimorë bazë të përbërë nga [...], kryetar dhe anëtarë [...]dhe [...]. Në këtë urdhër saktësohet se bëhet fjalë për marrjen në dorëzim të artikujve në bazë të kontratës nr.7/5, datë 20.04.2016 me objekt Blerje ushqimi bazë për sistemin e burgjeve.

58.Shkresa nr.3472, datë 09.05.2016 nënshkruar nga drejtuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve [...], drejtuar Operatorit ekonomik “[...]” sh.p.k, njoftim për dërgimin e disa artikujve ushqimorë në bazë të kontratës nr.7/5, datë 20.04.2016 si dhe urdhëri nr.3471, datë 09.05.2016 për magazinimin e këtyre artikujve ushqimorë.

59.Procesverbal për marrjen e mostrave, datë 16.05.2016 mbajtur nga anëtarët e komisionit për marrjen në dorëzim të artikujve ushqimorë, [...], kryetar dhe anëtarë [...]dhe [...].

60.Procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit të ardhur nga subjekti “[...]” sh.p.k datë 20.05.2016, ku komisioni i përbërë nga [...], kryetar dhe anëtarë [...] dhe [...] kanë vendosur të marrin në dorëzim mallin dhe që malli të bëhet pjesë e magazinës.

61.Vendimet e gjykatës të cilat është lejuar përgjimin e telefonave sipas parashikimit të nenit 221 e vijues të K.Pr.Penale, menjëherë pasi është regjistruar procedimi penal.

Kështu, me vendim nr.40, datë 30.01.2016 është vleftësuar i ligjshëm autorizimi i prokurorit datë 29.01.2016, ora 13.15 për përgjimin telefonik celular të numrave [...] dhe [...]për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar nga data 29.01.2016, ora 13.15; me vendim nr.232, datë 17.04.2016 është vleftësuar i ligjshëm autorizimi i prokurorit datë 16.04.2016, ora 11.00 për përgjimin telefonik celular të numrave [...],[...],[...]dhe [...], për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar nga data 16.04.2016, ora 11.00; me vendimin nr.271, datë 30.04.2016 është zgjatur afati i përgjimit të komunikimeve hyrëse dhe dalëse të numrave telefonikë celularë [...],[...],[...]dhe [...], për një afat 40 ditor, duke filluar nga data 30.04.2016; me vendim nr.302, datë 11.05.2016 është vleftësuar i ligjshëm autorizimi i prokurorit datë 09.05.2016, ora 19.30 për përgjimin telefonik celular të numrit [...], për një periudhë 15 ditësh, duke filluar nga data 09.05.2016, ora 19.30; me vendim nr.307, datë 12.05.2016 është vleftësuar i ligjshëm autorizimi i prokurorit datë 10.05.2016, ora 19.30 për përgjimin telefonik celular të numrit [...], për një periudhë 15 ditësh, duke filluar nga data 10.05.2016, ora 19.30; me vendim nr.312, datë 13.05.2016 është vleftësuar i ligjshëm autorizimi i prokurorit datë 12.05.2016, ora 10.00 për përgjimin telefonik celular të numrit [...], për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar nga data 12.05.2016, ora 10.00; me vendim nr.352, datë 24.05.2016 është zgjatur afati përgjimit telefonik, i komunikimeve hyrëse dhe dalëse të numrit telefonik celular [...], për një afat 40 ditor, duke filluar nga data 24.05.2016; me vendim nr.354, datë 25.05.2016 është zgjatur afati përgjimi telefonik, të komunikimeve hyrëse dhe dalëse të numrit telefonik celular [...], për një afat 40 ditor, duke filluar nga data 25.05.2016; me vendim nr.360, datë 26.05.2016 është vleftësuar i ligjshëm autorizimi i prokurorit datë 24.05.2016, ora 19.00 për përgjimin telefonik celular të numrit [...], për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar nga data 24.05.2016, ora 19.00; me vendim nr.361, datë 27.05.2016 është zgjatur afati i përgjimit telefonik të komunikimeve hyrëse dhe dalëse të numrit telefonik celular [...]për një afat 40 ditor, duke filluar nga data 27.05.2016; me vendim nr.362, datë 27.05.2016 është vleftësuar i ligjshëm autorizimi i prokurorit datë 25.05.2016, ora 17.00 për përgjimin telefonik celular të numrit 069 38 22 762, për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar nga data 25.05.2016, ora 17.00; me vendim nr.396, datë 08.06.2016 është lejuar përgjimi telefonik dhe është dhënë autorizimi për

përgjimin e komunikimeve hyrëse dhe dalëse të numrit telefonik celular [...], për një periudhë prej 15 ditësh; me vendim nr.397, datë 08.06.2016 është zgjatur afati i përgjimit telefonik i komunikimeve hyrëse dhe dalëse të numrave telefonikë celularë [...],[...],[...]dhe [...], për një afat 40 ditor, duke filluar nga data 09.06.2016; me vendim nr.79, datë 13.02.2016 është vleftësuar ligjshëm vendimi i prokurorit datë 12.02.2016 për përgjimin ambiantal të bisedave midis administratorëve të firmave “[...]”, “[...]”, “[...]”, “[...]” dhe “[...]”, gjatë takimit të tyre te lokali në zonën e “[...]”, në lokalin “[...] [...]”, në pronësi të shtetasit [...], duke filluar nga ora 13.30 e datës 12.02.2016 dhe deri në orën 24 të kësaj date.

62.Procesverbalet e transkripteve të përgjimeve telefonike, nga të cilat ka rezultuar si më poshtë:

a.Lidhur me tenderin datë 31.05.2016.

Me datë 19.04.2016, ora 15.03.031 përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr përdoruesin e numrit 0662070417, duke e thirrur “[...]”, duke e vënë në dijeni të faktit që do të mbyllet “[...]” atë ditë apo të nesërmen. Nga komunikuesi kërkohet të dihet nëse kishte shkuar në një takim dhe si e kishin lënë. I pandehuri [...] Kala përgjigjet “[...]” ndërsa pyetet nga bashkëbiseduesi “[...]” dhe jep përgjigjen i pandehuri [...]: “[...]”.

Me datë 19.04.2016, ora 15.33.042 përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merret në telefon nga përdoruesi i numrit [...], shtetasi [...]. I pandehuri [...] e vë në dijeni të faktit që ka shkuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe se ishte bërë kalimi i lekëve të vlerave të faturave, por jo plotësisht dhe jo duke i ndarë vlerën e çdo fature, por në bllok. E siguron bashkëbiseduesin se të nesërmen në mëngjes deri në orën dhjetë do ti kishte atje në llogari.

Me datë 19.04.2016, ora 21.39.50 përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merret në telefon nga përdoruesi i numrit [...] që rezulton të jetë i pandehuri [...]. Komunikohet sërish për vajtjen në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, pasi kishin kaluar lekët e muajit, por i pandehuri [...] shprehet se është i paqartë për vlerën e faturave që kanë kaluar. Shpreh shqetësimin se përfaqësuesi i subjektit “[...]” e ka marrë në telefon duke kërkuar vlerën që i takon. Shprehet se do të shkonte nesër nga ora 09.00 të sqarohet dhe më tej do t’i ndante lekët. Në këtë bisedë i pandehuri [...] shprehet për koston e kolaudimit dhe se më mirë ishte ti zgjidhnin gjërat me rregulla dhe të mos paguanin “gjoba”. Konkretisht ai i thotë të pandehurit [...] “...[...]”. Nga i pandehuri [...] i vihet në dijeni rreth faktit se ato që do të kolaudonin këtë radhë ishin ato çunat, [...] dhe [...], dhe iu kishte thënë të mos i bënin numra “[...]...”, shprehet se ata nuk ia kishin varur dhe se me ata kishin qëndruar me të vetëm dy minuta në këmbë.

Me datë 19.04.2016, ora 09.02.08 përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin i numrit [...] që rezulton të jetë i pandehuri [...]. Ky i fundit e vë në dijeni bashkëbiseduesin se po shkon tek burgu 313 dhe se do ta merrte në telefon kur të shkonte atje. Në të njëjtën ditë, 19.04.2016 ora 21.18.54 përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit [...] që rezulton të jetë i pandehuri [...], duke i thënë pse nuk kishte komunikuar me të tërë ditën. I pandehuri [...] i thotë se do të flisnin nesër dhe e pyet nëse e kishte lidhur kontratën, duke shfaqur dhe mendimin e tij, “[...]”. I pandehuri [...] i shprehet “[...]”. Gjithashtu i thotë se kishte vajtur tek [...]a në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjevedhe se kishin kaluar lekët, por ai nuk e di çfarë kishte kaluar dhe se do t’ia kalonte dhe bashkëbiseduesit nesër. I pandehuri [...] kërkon të mos ia kalojë lekët, por të priste të flisnin të nesërmen.

Me datë 20.04.2016, ndërmjet të pandehurit [...] dhe të pandehurit [...] bisedohet për mundësimin e përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm nga i pandehuri [...], me qëllim lidhjen e një kontrate me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve nga subjekti “[...]” shpk me administrator të pandehurin [...].

Me datë 20.04.2016, oras 09.18.28, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit të telefonit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] Laska, duke e lënë të takohen “tek burgjet”. Pak minuta më vonë, në orën

10.38.01, i pandehuri [...] e merr sërish në telefon të pandehurin [...] dhe e pyet çtë bëjë me lekët që kishin kaluar. Flitet për fatura të subjektit “[...]”, administratori [...] dhe i pandehuri [...] shprehet se, i detyrohet këtij subjekti [...]ë, ndërsa i pandehuri [...] shpreh habi lidhur me këtë dhe i thotë se kishte dhe faturat e tij të shkurtit për të paguar.Në orën 11.05.27, i pandehuri [...] e vë në dijeni të pandehurin [...] se i ka kaluar subjektit “[...]” shtatë milion lekë të reja, ndërsa ai i përgjigjet se do të komunikonte me të në telefon. I pandehuri [...] e vënë dijeni se i ka kaluar lekë dhe Azbiut dhe shprehet i meraksour sesi do të behej ndarja e pjesës tjetër: “.. [...]”.

Me datë 20.04.2016, ora 11.21.17përdoruesi numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit [...] që rezulton të jetë i pandehuri [...], duke e vënë në dijeni të faktit që i kishte kaluar 40 milion lekë në bankën “[...]” dhe se duhet të ulëshin dhe të shihnin llogaritë. Ndërsa i pandehuri [...] shprehet “ky muaj do të ndahet midis dy kontratave”.

Me datë 20.04.2016, në orën 17.56.05, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merret në telefon nga përdoruesi i numrit [...] dhe vihet në dijeni të fakti se kishte takuar një person “[...]”. Pyet dhe të pandehurin [...] tia jepnin apo jo këtë vlerë. Ky i fundit i thotë të priste ti jepnin një herë deklaratën e tërheqjes, duke i përshkruar dhe përbajtjen e deklaratës së heqjes dorë “[...]”, deklaratë e cila duhet të ishte me vulë, pastaj tia jepte njëshen.

Me datë 20.04.2016, përdoruesi i numrit telefonik [...] që rezulton të jetë i pandehuri [...] merret në telefon nga përdoruesi i numrit [...], i thirrur [...]. I pandehuri [...] e vë në dijeni të fakti se nesër do të firmoste: “[...]”.

Me datë 20.04.2016, ora 14.00.42, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merret në telefon nga numri [...], duke iu prezantuar “Nga Drejtoria e Burgjeve marrim“, duke i thënë “[...]”. I pandehuri [...] shprehet dakort: “[...]”.

Me datë 20.04.2016, ora 14.01.45,pak sekonda më vonë se biseda e të njëjtit numër me të pandehurin [...], përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merret në telefon nga përdoruesi i numrit [...], duke iu prezantuar,nga Drejtoria e Burgjeve nga informacioni marrim. Duheni të paraqiteni për. I pandehuri [...] shprehet dakort, “[...]” dhe bashkëbiseduesi i jep informacion për tu paraqitur në zyrën e prokurimeve. I pandehuri [...] dhe i pandehuri [...] njoftohen njëherazi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për të lidhur një kontratë. Në fakt, referuar procesverbalit të sekuestrimit të një sërë praktikash, procesverbalit te datës 28.06.2016, nga ku janë sjellë si prova vetë me dokumentat në kuadër të procedurës së tenderimit datë 31.05.2016, ka vetëm një kontratë të lidhur me subjektin “[...]” me administrator të pandehurin [...] Laska datën e këtij përgjimit, 20.04.2016, pra jo kontratë të lidhur me subjektin e përfaqësuar nga [...], “[...]” shpk. Në vijim të bisedave me numrin [...], numër në përdorim të një personi në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ndërmjet të pandehurve [...] Kalja dhe [...] vijoje këto komunikime:Në orën 14.12.48, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merret në telefon nga përdoruesi i numrit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], të cilin i pandehuri [...], i thirrur [...] e thërret [...]. I pandehuri [...] i kërkon të shkojë dhe të firmosë kontratën, të merrte vulën me vete dhe sigurimin e kontratës që kishte bërë. Pak minuta me vonë, në orën 14.29.31, i pandehuri [...] merret në telefon nga i pandehuri [...], i cili e pyet ku ishte, ndërsa ai i përgjigjet se po bënte sigurimin e kontratës, pasi i kërkohej me datën e sotme. Pak minuta më vonë, në orën 14.45.56 i pandehuri [...] merr në telefon përdoruesin e numrit [...] dhe i thotë të komunikonte me “Eurosigun“të ndryshonte datën në kontratën e sigurimit që kishin bërë për llogari të Drejtorisë së Burgjeve, pasi kërkohej kontrata me datën e sotme, më vonë do tia çonin kopjen origjinale.Pak minuta më vonë, në orën 14.47.43, i pandehuri [...] merr në telefon të pandehurin [...], duke e pyetur ku ishte, ndërsa ai i përgjigjet se e mori kontratën dhe po shkonte. I pandehuri [...] ankohet se kontrata nuk ishte gati dhe ai po largohej. I pandehuri [...] i përgjigjet se ashtu e kishin lajmëruar dhe se ata vetëm gënjejnë.

Me datë 21.04.2016, ora 14.05.34, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merret nga përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], dhe i thuhet ti jepet ndonjë lek, “ [...]”. Ndërsa i pandehuri [...] përgjigjet që duhet të ulëshin dhe të bënin llogaritë dhe e informon se i ka kaluar [...] milion lekë. Ndërsa i pandehuri [...] i kërkon [...], i pandehuri [...] e informon se i ka kaluar [...]it [...] miljon pardje si dhe faktin se e kishte firmosur kontratën. Lidhur me pagesat i pandehuri [...] e informon të pandehurin [...] se do ti merrnin të gjitha përnjëherësh.

Me datë 21.04.2016, ora 13.12.04 përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] merret në telefon nga përdoruesi i numrit [...], shtetasi i prezantuar [...], i cili e pyet nëse e përfunduan lidhjen e kontratave. I pandehuri [...] i përgjigjet se ishte atje dhe se po firmoste kontratat e do mblidheshin të bisedonin, përsirë dhe një shtetas të quajtur [...]. Në orën 19.29.10 i pandehuri [...] merret sërish në telefon nga përdoruesi i po këtij numri, shtetasi [...] dhe i thotë se nuk kishte mundur të mblidheshin pasi [...] i ka thënë se nuk ishte atje dhe [...] i kishte thënë se kishte ikur. E lënë të komunikojnë sërish nesër.

Me datë 22.04.2016, ora 18.42.48, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] merr në telefon përdoruesin e numrit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] dhe ne pyet pse nuk e ka ndërprerë me [...], atë furnizimin e [...]. I kërkon të mos çojë më furnizim në [...] në emër të tij. Debatojnë rreth këtij fakti dhe i pandehuri [...] i thotë se [...], siç duket, luan me shumë gjëra. Ndërsa i pandehuri [...] i thotë: “...[...]”.

Me datë 23.04.2016, ora 11.23.21, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit të telefonit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] dhe i kërkon ti japë lekët, pasi i ka thënë që pjesën e tij e kishte vënë ai. I pandehuri [...] i thotë se ka paguar 37, pa specifikuar më tej, dhe ska gjë për të vënë. Me këmbënguljen e të pandehurit [...], i pandehuri [...] merr përsipër tia japë, ndërsa [...]i i vë si afat ditën e hënë, duke i thënë se kishte hallin e tij.

Me datë 23.05.2016, ora 11.35.35 përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] merret në telefon nga përdoruesi i numrit telefonik [...], me emër [...], i pandehuri [...]. I pandehuri [...] e informon se po shkon nga drejtoria e burgjeve “[...]” dhe i pandehuri [...] i thotë: “[...]”. Bëhet fjalë për anulimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave, dhe të dy rezultojnë të kenë dijeni lidhur me këtë fakt, pavarësisht se operatori “[...]” shpk i përfaqësuar nga i pandehuri [...] nuk ka marrë pjesë në këtë tender, ndërsa [...] rezulton i njoftuar me shkresë për anulimin. I pandehuri [...] i thotë të pandehurit [...] “[...]”, duke nënkuptuar krijimin e statusit të fituesit dhe ai i përgjigjet: “[...]”. Në bisedë thuhet se do të takojë dikë, por nuk dëgjohet emri i tij. Në orën 11.43.49 i pandehuri [...] e merr sërish në telefon të pandehurin [...] në numrin tjetër të telefonit në përdorimit të tij [...]. I pandehuri [...] e pyet për arsyet përse shtyhet, duke i kërkuar të shohë letrën që i kishin njoftuar (flitet për anulimin e procedurës së tenderit) dhe ai i përgjigjet: “[...]...”. [...] i thotë se do ta marrë sërish në telefon “[...]”, duke nënkuptuar që gjendej në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe po priste dikë atje, për të folur pikërisht për këtë fakt. Në orën 12.19.16 i pandehuri [...] e merr sërish në telefon të pandehurin [...] dhe e pyet se çfarë bëri, ndërsa ai ([...]) i përgjigjet se po pret [...].n. Të pandehurit [...] dhe [...] e lënë të takohen për një çerek ore në zyrën e të pandehurit [...]. Në orën 13.06.33 përdoruesi numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] merr në telefon përdoruesin e numrit telefonik [...], të pandehurin [...] dhe e vë në dijeni të faktit se tani kishte mbaruar me [...].n. I pyetur nga i pandehuri [...] lidhur me ecurinë e bisedës, i pandehuri [...] përgjigjet: “[...]”. E lënë të takohen në zyrën e të pandehurit [...].

Me datë 24.05.2016, ora 15.41.40, përdoruesi i numrit telefonik telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] merr në telefon përdoruesin e numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...]. Ky i fundit e informon se sa kishte dalë nga “këtej” dhe se “ai” i kishte thënë do ta çojë lart dhe “*çtë më thotë ai*”. Nuk e kishte çuar akoma, se “[...] Gjithashtu i vë në dijeni dhe faktin se i kishte thënë “atij “*çdo gjë e kish teme [...]*”. Referuar shumë bisedave telefonike, rezulton që i thirrur [...] është i pandehuri [...].

Me datë 27.05.2016, ora 14.51.52, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon të pandehurin [...], përdoruesi i numrit të telefonit [...]. Biseda që zhvillohet ndërmjet tyre lidhet me tenderin që do të zhvillohet më datë 31 maj ora 14.00. I pandehuri [...] i bën me dije të pandehurit [...] se kishte dalë nga drejtoria dhe e kishte takuar dikë që i kishte thënë: “[...]”, duke nënkuptuar rrethanat sesi ishte anuluar tenderi dhe mundësinë e rregullimit të kësaj situatë. Biseda ndërmjet tyre kishte qenë, [...]“...[...]”. Bashkëbiseduesi, i pandehuri [...] i përgjigjet të pandehurit [...] se njoftimi nuk mbaronte atë ditë dhe se tenderi ishte në datën 31 maj, ora 2, “[...]”. I pandehuri [...] shprehet se nuk kishte rënë në batakun e tyre dhe se nuk do të linte të dështonte “[...]”, duke nënkuptuar fitimin e tenderit dhe duke propozuar të kujdeseshin vetë për ofertat që do të bënin, “[...]Ndërsa i pandehuri [...] shpreh shqetësimin se do të dështonin.

Fakti që bëhet fjalë pikërisht për tenderin e datës 31.05.2016, rezulton qartazi, nisur dhe nga fakti që në këtë datë, 27.05.2016 është bërë shpallja e procedurës së këtij tenderi me negociim pa shpallje paraprake dhe konteksti i bisedës tregon se mund të mbyllet që atë ditë kjo shpallje, ndërsa bashkëbiseduesi [...] shprehet i qartë se afati mbyllet më datë 31 ora 14.00 dhe personi nga ku kishin marrë garancinë, me të cilin kishte folur i pandehuri [...], mund t'ia “ofronte” statusin e fituesit një tjetri, të cilin mund dhe ta njoftonin vetëm 15 minuta më parë se sa ora 14.00, kur dhe zhvillohej tenderi, duke nënkuptuar se ata po luanin në dy drejtime. Nga përmbajtja e kësaj bisede, rezulton qartë se të pandehurit [...], [...], [...], janë kujdesur për të krijuar lidhje më të hershme se sa data e shpalljes së procedurës së tenderit, 27.05.2016, me të pandehurin [...], lidhje e krijuar nga [...]i, ku i fundit do të ruante lidhjet me të pandehurin [...], për të marrë prej tij përfitimet e paligjshme në vlera monetare.

Me datë 30.05.2018, ora 08.21.09, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon të pandehurin [...], përdoruesin e numrit të telefonit [...]. Biseda ndërmjet tyre lidhet me përgatitjen e ofertave, uljen e ofertave nga i pandehuri [...], përgatitjen e disa ofertave të ndërmjetme dhe mundësinë e takimit atë pasdite për tu ulur dhe për të diskutuar. Ndërsa i pandehuri [...] i thotë: “[...]”. Rezulton qartë se bëhet fjalë për procedurën e prokurimit që përkon me të nesërmen e bisedës, pra më datë 31.05.2016. Flitet se ka një [...] dhe se atë e kishte marrë [...] (i pandehuri [...]) për të marrë “[...]”. Ofertat i ka përgatitur i pandehuri [...], pasi i kërkohet kjo nga i pandehuri [...]: “...118: [...]”. Ndërsa i pandehuri [...] i shpjegon mënyrën sesi kishte përgatitur ofertat: “... [...]”. Në vijim në orën 17.04.53, përdoruesi i numrit telefonit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit të telefonit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], duke i thënë se dokumentat i kishte tek byrekët dhe se do takoheshin dhe do të flisnin nesër nga afër. I pandehuri [...] e pyet nëse ia kishte lënë të printuara dhe i pandehuri [...] ia konfirmon këtë fakt, duke e lënë të takohen nesër dhe të flisnin nga afër.

Me datë 31.05.2016, ora 08.57.07, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit të telefonit [...], të pandehurin [...]. I pandehuri [...] e bën me dije se po merret me ofertat dhe e pyet nëse ishte lidhur me Shemen, të pandehurin [...], ndërsa i pandehuri [...] shprehet se me të lidhej ai, pra i pandehuri [...]. Ky i fundit i thotë ti bënin dhe një ofertë [...], t'ia kishin, ndërsa i pandehuri [...] shprehet: “[...]”. Në përfundim bien dakort që nëse [...]i, pasi të shkonte në zyrë do të shihte që [...] nuk i kishte marrë kriteret, mos ti bënin ofertë, por orientohet nga i pandehuri [...] që këshillon që të bënin nga një ofertë për vete rezervë, duke nënkuptuar që secili operator i përfaqësuar prej tyre mund të kishin me vete disa oferta, e dhënë kjo e përfutur dhe nga biseda e datës 30.05.2016 ndërmjet të pandehurve [...] dhe [...].

Me datë 31.05.2016, ora 12.32.43, përdoruesi i numrit të telefonit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] dhe i pyet nëse do të pinin kafe “[...]” dhe ndërsa merr konfirmimin “*Po patjetër*” të të pandehurit [...], e pyet: “[...]”. Ai i përgjigjet se është në [...]dhe do të kthehej në Tiranë, ndërsa i pandehuri [...] i thotë ti bënte një telefon kur të kthehej. Në të njëjtën ditë vijojnë bisedat me mesazhe ndërmjet të pandehurve [...] dhe [...]: Në orën 15.43.22 i pandehuri

[...] i dërgon mesazhin “[...]” dhe e menjëhershme, ora 15.44.21 është përgjigjja e të pandehurit [...]: “[...]” dhe mesazhi i dytë i dërguar ora 15.44.31 “*për atë punën*”. Me tej biseda vijon, i pandehuri [...], “[...]”, “[...]”, “[...]”, i pandehuri [...]. Në orën 12.54.29, përdoruesi i numrit telefonik , që rezulton të jetë i pandehuri [...], komunikon me përdoruesin e telefonit [...], të pandehurin [...], duke e lënë për të pirë kafe në atë moment, tek ushtari i panjohur: “[...]sqaron vendin ku do takohen i pandehuri [...]. Disa minuta më pas, ora 13.01.20, i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit , që rezulton të jetë i pandehuri [...], dhe mëson prej tij se ai po shkonte, ishte afër [...]-së. Në orën 13.59.53, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], komunikon, me përdoruesin e numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...]. E pyet atë [...], nëse kishte ndonjë problem dhe bashkëbiseduesi i thotë “[...]”.

Me datë 31.05.2017, ora 16.46.10, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] merr në telefon përdoruesin e numrit të telefonit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] dhe pasi e pyet, “*Hë mo?*”, merr prej tij përgjigjen se ishin akoma atje, pra në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, “*skanë mbaruar ato llojet ..*”. I pandehuri [...] i thotë: “*Ca thua ti ore...A të shkoj të ulem tek [...] do paguajë drekë ai*”. Ndërsa i pandehuri [...] përgjigjet “*Po ore, këtu e kam... tek [...]...*”.

Me datë 31.05.2016 ora 19.50.02, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merret në telefon nga përdoruesi i numrit të telefonit [...] [...]. Komunikuesi [...] e pyet se çfarë ishte bërë, ndërsa i pandehuri [...] i përgjigjet se sapo kishin dalë dhe po hanin, drekë dhe darkë bashkë, tek lokal “[...]”. Gjithashtu, pas interesimit të bashkëbiseduesit [...] “*çar u bë*”, i pandehuri [...] e informon atë, “*Iço, e mbyllëm një çikë me dinakëri*”, bashkëbiseduesi [...] e pyet, “*Me ulje*”, i pandehuri [...] i përgjigjet, “*Jo jo me ulje*”. Pas interesimit të komunikuesit [...] “*kush u la*”, duke nënkuptuar se cili ishte fituesi i tenderit, përgjigjja e të pandehurit [...] është, “*Ee, ai [...]*”, pra operatori ekonomik i përfaqësuar nga i pandehuri [...], “*e mirë*” përgjigjet bashkëbiseduesi [...].

Të dhënat e përfuara nga përgjimi i të pandehurve, një ditë para tenderit, rezultojnë të lidhura me ato të përfuara nga përgjimet e të pandehurve ditën e zhvillimit të tenderit, 31.05.2016, por dhe me raportet e vëzhgimit të kësaj date, ku evidentohet shoqërimi paraprak i katër të pandehurve dhe përpjekjet e tyre për tu lidhur/takuar me njëri - tjetrin përpara zhvillimit të tenderit.

Me datë 03.06.2016, ora 14.02.19, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri Iljal Labi, i dërgon një mesazh përdoruesit të numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] me këtë përmbajtje, “*Si je zotni*”. Po me mesazh i përgjigjet ky i fundit, në orën 14.13.23, “*Mirë shefo*”. “*Unë jo dhe aq mirë*”, i përgjigjet i pandehuri [...]. Përgjigjja e të pandehurit [...], “*Po i kam thënë [...] të vijë të takojë me koh*”. Sërish me mesazh përgjigjet i pandehuri [...] “*Shife takohemi pimë një kafë ose më thuaj nëse nuk ke kohë vlla dhe nuk ka problem fare*”. Ndërkohë i pandehuri [...] i betohet “*Për zotin i kam thënë me kohë se nuk jam kalamo unë megjithatë do të kthehem në Tiranë dhe do ta marr dhe at*”. Përgjigjja e të pandehurit [...]: “*Ok*”.

Me datë 03.06.2016, në orën 14.26.05, teksa vijonte komunikimin me mesazhe më të pandehurin [...], përdoruesi i numrit telefonik telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] merr në telefon përdoruesin e numrit të telefonit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...]. Gjatë kësaj bisede, pasi zhvillohet në fillim një bisedë pa interes përse i përket çështjes, i pandehuri [...] i kërkon të pandehurit [...]: “*Eee po shko takojë një çikë atë dyshin se më çmendi me mesazhe, i thashë se i kam thënë [...] të të vijë të takojë...*”. I pandehuri [...] shprehet se dy herë se ka gjetur aty dhe se nuk e kishte marrë më mundimin të shkonte. E pyet të pandehurin [...] “*po një apo dy*” dhe përgjigjja e të pandehurit [...] është, “*Po dy o burrë tani, se sjemi kalamaj.....të mbajmë ekuilibër o burrë*”, duke i sqaruar se kanë mbajtur ekuilibër gjithë këto kohë. Ndërsa i pandehuri [...] shprehet se “*spo iu ngelet gjë*”, i pandehuri [...] shprehet se “*e kemi bërë vetë në atë mënyrë*”.

Rezulton qartë se i pandehuri [...] vijon të kërkojë vlerën e rënë dakort lidhur me tenderin e zhvilluar më datë 31.05.2016 nga i pandehuri [...], ndërsa ky i fundit i thotë se kishte

folur me [...]n për tia çuar, që sikurse pranon i pandehuri [...], pikërisht ky dhe ia ka dhënë këtë vlerë prej dy milion lekë. Shifra e përmendur në bisedën ndërmjet të pandehurve [...] dhe [...] për tia çuar të pandehurit [...], pra “dy” përputhet me vlerën e deklaruar nga i pandehuri [...] në seancë gjyqësore, dy milion, si të marrë nga i pandehuri [...] dhe deklarimin e dhënë në hetime paraprake nga i pandehuri [...], pra vlerën prej dy milion lekë, vlerë kjo e përafërt me vlerën 10% të vlerës së tenderit (fondit limit 18.883.800 lekë pa TVSH dhe vlerën [...]lekë me TVSH).

Me datë 04.06.2016, ora 13.56.02, ku përdoruesi i numrit telefonik [...] i pandehuri [...] merr në telefon përdoruesin e numrit të telefonit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], duke i thënë, “*Më tha [...], të ka dhënë [...]lekë për të mi dhënë mua*”. Ndërsa i pandehuri [...] i thotë se nuk ia kishte dhënë për të, pa i treguar për cilin ia kishte dhënë [...]ju, duke i thënë shprehimisht, “*Po të them unë kur të flas në [...] për ku. Se nuk flas dot në telefon*”. Ndërsa i pandehuri [...] këmbëngul duke i thënë, “[...] ti ka dhënë ty, edhe më tha, më mori vetë, i kam dhënë [...]it, se nuk jam tu lëviz, tha. I kam dhënë [...]it [...]lekë, tha për të mbyllur ato”, ndërsa i pandehuri [...] i thotë që kur të vinte vetë [...] në [...] flasim dhe ti jap unë, duke këmbëngulur, “*Jo dorë për dorë, mua mi ka dhënë për gjetskë*”, pasi i pandehuri [...] i ka thënë “*prandaj po them unë, kalon dorë më dorë kjo punë*”, ndërsa i pandehuri [...] kundërshton, “*Jo dorë për dore mua mi ka dhënë për gjetskë*”.

Me datës 04.06.2016, ora 13.54.31, i pandehuri [...], duke përdorur numrin tjetër të telefonit [...], merr në telefon të pandehurin [...], dhe i thotë se e kishte marrë në telefon [...]. I kishte kërkuar njëzet milion lekë që atij [...]it, ia kishte dhënë [...] për t’ia dhënë atij, [...]. I pandehuri [...] i thotë ti jepte ndonjë lekë [...], të mos iua çante veshët dhe [...]i i bën të qartë se [...] kërkonte njëzet milion. I pandehuri [...] i thotë ti jepte çfarë të kishte mundësi, duke u shprehur: “*ti e pe çar të bën ai legen*”. Biseda përfundon duke i thënë i pandehuri [...] të pandehurit [...] Laska ti jepte çfarë të donte, dhe nëse nuk kishte të mos i jepte, rrethanë kjo që hedh poshtë pretendimet që vlera që duhet ti jepej [...]it ishte e lidhur me furnizime të mëparshme të kryera nga [...]i në favor të subjektit të përfaqësuar nga i pandehuri [...].

Me datë 06.06.2016, në orën 18.23.57, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] merr në telefon përdoruesin e numrit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], duke i thënë se i duheshin ca lekë, konkretisht lekët që [...] i kishte dhënë [...]it për t’ia dhënë atij. Ndërsa i pandehuri [...] i përgjigjet se është në dijeni të faktit se [...] dhe [...], [...], ishin bashkë në atë moment dhe se ai ia kishte shpjeguar situatën [...]it. I pandehuri [...] e pyet për ku ti ka dhënë, ndërsa i pandehuri [...] i thotë të pyese [...] se ia kishte shpjeguar dhe nuk mund të fliste më tej në telefon. I pandehuri [...] i pyetur nga i pandehuri [...], përgjigjet, “*Si të sqaroi ty laraska*”, përgjigjet: “*Ai më tha që merri dhe atje ku the ti radhën e parë, tani ti më thua kështu dhe unë po habitem çar të bëj*”. Në vijim i pandehuri [...] i bën të qartë “*Jepja botit që të ka thënë emrin...edhe pikë., [...] e ka emrin*”, ndërsa i pandehuri [...] shprehet se “*ai mi dha për gjetskë mua o shok*”.

b.lidhur me kolaudimine mallrave që ka marrë DPB, nga nga subjekti “[...]” shpk.

Me datë 11.05.2016, ora 13.21.50, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], i ka çuar si mesazh përdoruesit të numrit të telefonit [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], pikërisht mesazhin që i kishte çuar në orën 11.18.37 përdoruesi i numrit telefonik [...], i pandehuri [...], “*Dua të takoj të pres sot*”. I pandehuri [...], pasi ka marrë këtë mesazh nga i pandehuri [...], në orën 13.22.50, e merr atë në telefon dhe e pyet nëse këtë mesazh ia kishte nisur gabim. I pandehuri [...] i përgjigjet se ishte i njëjti mesazh që ia kishte nisur “*ai*”, duke sqaruar në vijim “*ma dërgoi [...] këtë*” dhe i kërkon [...]it të shkojë ta takojë, [...]n. I pandehuri [...] i bën të qartë të pandehurit [...] se ai kishte vetë telefon dhe [...] mund ta merrte atë dhe se ai nuk kishte për të shkuar për ta takuar. I pandehuri [...] i thotë se dhe ai ishte shumë dakort kështu, pasi takimi ishte me “*kosto*”, “*...Në rregull jam unë, në qoftë se ti thua ashtu, unë jam dhjetë herë, dua që të mos e takojmë, sepse kosto kemi, po unë po të bëj me dije çar na ka thënë*”. I pandehuri [...] shprehet se ai nuk e quan dije atë që i thotë i pandehuri [...]. Ndërsa [...] i shprehet se e kishte takuar para disa ditësh të pandehurin [...] në drejtori dhe i kishte bërë të qartë se në këtë procedurë ishte tjetër firmë kontraktuese dhe jo firma e tij dhe se

ai ai ishte thjesht furnitor. Ndërkohë, i pandehuri [...] shpreh pakënaqësinë që i pandehuri [...] kishte mbajtur këtë qëndrim, duke e “ngarkuar atë” pra [...]in, me detyrimin e përmbushjes së kërkesës për përfitim të parregullt të të pandehurit [...] të lidhur me këtë procedurë, duke i thënë [...], “...e mirë i ke thënë, po si ke thënë fort mirë”.

Rezulton, se të pandehurit [...] dhe [...] e kanë kuptuar që mesazhi dhe telefonatat e të pandehurit [...] me të pandehurin [...], kanë si qëllim kërkimin prej tij të vlerave të caktuara monetare, të cilat janë “kosto” e lartë për ta.

Me datë 16.05.2016, ora 13.04.11, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], dhe merr vesh prej këtij të fundit se ishte në [...]. I pandehuri [...] e pyet, “...Heee, jemi këtu në [...], pse si ke ashtu atë [...]t, atë të asaj...”. I pandehuri [...] i thotë ti bënte të fala [...]t, por ai nuk ia kishte varur një ditë. I thotë se do të autorizonte për të shkuar në [...] “atë”, pra [...]n dhe se [...] mund të shkonte në [...] “po t’ia mbante të shkonte”. Duke menduar se [...] ishte me [...]n, [...]i i kërkon atij t’ia kalojë në telefon [...]n. I pandehuri [...] i thotë se ishte shkëputur dhe kishte shkuar pak tek informacioni dhe e këshillon të pandehurin [...] t’a merrte vetë [...]n në telefon, ndërsa [...]i i thotë që do t’a merrte nga numri i vet. Këtë telefonatë me të pandehurin [...] marrë përsipër për ta kryer, i pandehuri [...] nuk e ka bërë, por, rreth një orë më vonë vjen kjo bisedë, në orën 14.40.56, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], duke iu prezantuar, “Jam [...]”. E bën me dije se po shkonte në [...] dhe në [...] dhe në [...] nuk po shkonte asnjë nga të firmës subjektit “[...]”, për të qënë prezent në marrjen e mostrave. I pandehuri [...] i përgjigjet se nuk kishte problem që nuk ishte njeri dhe se kishte autorizuar [...]n, madje i thotë, “E njef ti një [...]”, ndërsa përgjigja e të pandehurit [...] është, “Jo nuk e njoh fare [...]n dhe nuk e kam idenë se nga është”. I pandehuri [...] i bën me dije se i kishte dhënë [...] “dokumenta me firmë e vulë”, ndërsa i pandehuri [...] shprehet se “Ouu ai nuk na i paraqiti”. I pandehuri [...], pasi ftohet nga i pandehuri [...] për të shkuar “në katundin e tyre” përgjigjet që atje ishte larg dhe të zbrisnin nga zyra se kishte dhe shumë biseda. I thotë se nuk mund të pinin kafe, pasi nuk ishin shokë, por kishin vetëm marrëdhënie pune dhe se kafe do të pinin kur të bëheshin shokë. I bën me dije bashkëbiseduesit [...] se po shkonte në [...] dhe më tej në [...] dhe se do ti njoftonte për rezultatet. I pandehuri [...] i thotë se do takoheshin nesër për kafe, ndërsa i pandehuri [...] i thotë se, “Nuk kam kohë për kafe, por hajde nesër”.

Rezulton që i pandehuri [...], ishte i pakënaqur me sjelljen e të pandehurit [...], në kushtet kur nuk i kishin dhënë një shpërblim/përfitim lidhur me këtë procedurë kolaudimi. Madje ai, nisur nga konteksti i bisedës, e ka “kërcënuar” të pandehurin [...] se ishte ai që duhet të ishte i interesuar për këtë situatë, duke qënë e lidhur kontrata me subjektin “[...]” dhe jo me [...]n. Për këtë të fundit shprehet se nuk e njihnte, duke nënkuptuar që nuk kishte lidhje me të në këtë rast, pasi njohja ndërmjet tyre ([...]t dhe [...]) rezulton e qartë, në kushtet e mesazhit të nisur atij, [...] nga [...], më datë 11.05.2016, duke i kërkuar të takohen “Dua të takoj të pres sot”.

Me datë 18.05.2016, ora 10.40.12, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], merr në telefon përdoruesin e numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...], duke e pyetur kur do të kalonte andej dhe kur do takoheshin: “Kur të duash ti o vlla... aty tek puna je ti?”, është përgjigjja e të pandehurit [...], që merr përgjigjen nga bashkëbiseduesi Iliaz: “e në zyrë jam unë nga je ti je larg“. Pasi i pandehuri [...] e vë në dijeni se është në qendër dhe do të mbaronte ca punë tek bashkia, i pandehuri [...] i thotë “E mirë...kur të mbarosh, mirë hajde “. Rreth dy minuta më pas, përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] merr në telefon përdoruesin e numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] dhe i thotë se e kishte marrë në telefon “ai shoku jot”, “[...]” dhe i kishte kërkuar të shkonte ta takonte, duke i lënë të kuptonte se duhet të shkonte ai, pra [...], t’a takonte. I pandehuri [...] shprehet se nuk e di çfarë donte ai, pasi ai kapitull ishte mbyllur, ishte parë malli

në [...] dhe [...] dhe janë marrë mostrat, ishin çuar në [...], në prezencë dhe të [...], kjo e fundit rezulton anëtare e komisionit të kolaudimit, i pandehuri [...] e pyet *“I ke premtuar gjë ti”*, ndërsa i pandehuri [...] shprehet se nuk i kishte premtuar, *“jo, jo absolutisht, ore nuk shprehem unë pa u kopsitur, kur jam në marrëdhënie me të tjerë, e kupton...absolutisht nuk dal jasht formatit unë”*. I thotë se kur kishte shkuar në [...] dhe Peqin, [...] iu kishte thënë *“Ku jeni se erdha unë...”*, ndërsa ai i kishte thënë, *“...Dëgjo, unë furnitor jam, po më dha ai lekë për mallin që kam blerë, i thashë unë mirë, po mos më dha ai, unë e çoj në gjykatë po smë dha lekët”*. I pandehuri [...] pyet të pandehurin [...] se çfarë ti thoshte shtetasit [...] që e kishte marrë në telefon dhe [...] i thotë: *“shko dhe merrja mendjen ...qysh e tek, sa e ka atë...”*, se malli ishte ekstra me të gjithë parametrat, etiketat, skadencat dhe gjithçka. Në orës 14.27.23 përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] merret në telefon nga përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...] dhe pyetet prej këtij të fundit: *“Hë re ashtu ti me atë”*, ndërsa i pandehuri [...] i thotë: *“Po jo i thashë unë, ke punë me [...]n, atë shokun tat, me mu, po do me ardh ke mua, dhomën e ke në dispozicion, restorantin në dispozicion, kaq kam në dorë unë i thashë”*. I pandehuri [...] i bën me dijeni se i kishte thënë se gjërat e tjera i ke me [...]n... *“ai është shefi i asaj pune, [...] është [...]”*.

Medatë 23.05.2016, mallrat janë bërë hyrje në magazina, referuar fletës së magazinimit nr. 11 datë 23.05.2016 dhe i pandehuri [...], vijon të jetë në pritje të përfitimit monetar për të cilin kishte rënë dakort me të pandehurin [...], por që do ti jepeshin atij nga i pandehuri [...], në rolin e furnitorit në këtë procedurë. Në orën 14.30.45i pandehuri [...], merr në telefon të pandehurin [...], duke e vënë në dijeni *“..ne i kemi mbaruar të gjitha procedurat, gjërat”*. I thotë *“E rëndësishme është të jeni mirë ju, po ne, ska problem, rregullohemi rrugës.... na jep naj çaj kur të kesh kohë”*. Ndërsa i pandehuri [...] përgjigjet, *“Mirë drejtor, ajde se takohemi pa merak...”*.

Me datë 25.05.2016, ora 10.22.06përdoruesi i numrit telefonik [...], që rezulton të jetë i pandehuri [...]merr përdoruesin e numrit[...] që rezulton të jetë i pandehuri [...], duke e thirrur këtë të fundit dhe me emër *“..o [...]”*, duke shprehur shqetësimin pse ishte e pamundur apo shumë e vështirë për ta takuar atë, pasi i ka bërë njëzet mesazhe dhe se ashtu nuk kishte lezet. Ndërsa ai i shprehet *“...Po po do të vi...sot do vij”*. Ndërsa i pandehuri [...] i thotë që nëse nuk shkonte atë ditë të mos shkonte fare. *“Po nuk erdhe sot mos hajde fare me, nuk i du fare mëpo serdhe sot”*, duke marrë përgjigjen e prerë nga i pandehuri [...] *“Jo, jo absolutisht”*. I shqetësuar nga kjo telefonatë e orës 10.22.06 me të pandehurin [...] dhe i shoqëruar nga pakënaqësia për ti dhënë atij përfitim monetar, i pandehuri [...] në bisedën e orës 12.07.55me të pandehurin [...], shqetësohet se i pandehuri [...] ia kishte përcjellë atij *“atë ufon”*, “[...]”, flitet për të pandehurin [...]. Ndërsa i pandehuri [...] i bën të qartë se ai e kishte detyrë, kështu e kishin lënë, duke nënkuptuar një marrëveshje ndërmjet tyre për këtë, të arritur ndërmjet tyre një ditë më parë: *“Ti e ke detyrë, jo se e kam përcjellë unë, a e lam ne..... se do noj gjë ai unë të thashë që dje..”*, takimi një ditë më parë, pra më datë 24.05.2018 ndërmjet të pandehurve [...] dhe [...] rezulton ngaprocesverbali i vëzhgimit datë 24.05.2016, ku janë parë të dalin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.Prej të pandehurit [...] mbahet ky qëndrim, *“po unë... ne jse gjoja të dalim si pa lagur e burr”* si dhe që ai ishte thjesht furnitor, duke u shprehur dhe se nuk i kishte dalë gjë këtë radhë atij, pra [...]t. I pandehuri [...] i kërkon të shkojë të mbarojë punë, *“Epo mirë, shko takoje aty nga kati i parë ngjitu në kat të dytë”* dhe se ai, pra [...], do të shkonte dhe vetë atje tani. I pandehuri [...] i thotë se po vinte dhe e fton të hyjnë bashkë, *“...ja të hymë ja të vij...”*. I pandehuri [...] i thotë se kishte punët e tij në kat të parë, ndërsa i pandehuri [...] i thotë që ai mund të ngjitej nga kati i parë dhe në kat të dytë, duke nënkuptuar shkuarjen në zyrën e të pandehurit [...], e cila gjendej në kat të dytë të godinës.Përgjigjja e të pandehurit [...] është: *“Jo jo nuk shkoj në kat të dytë unë, harroje atë muhahabet ska punë me mu ai, hajt tani se fillon xhelozia he burrë nëpërmjet atyre të tjerëve leje të mbyllim këtë punën që kena në dorë iher. Mbaroje ti atë punë atje lart a kupto se ..se isha vet sot ven tjetërunë...a kupto ene kujtojnë se bojmë kshu a kupto shkojmë ktu e shkojmë atje a kupto...”*. I pandehuri [...] ngul këmbë: *“Unë kam punë në kat të parë a e kupton “.....nuk shkoj dot në kat të dytë tani për*

arsye....shkoje mbaroje katin e dytë ...a ma kupto idenë”. Ndërsa përgjigja e të pandehurit [...] “Po mo po ...në rregull”.

63. Autorizime të prokurorit për kryerjen e veprimeve të përgjimit ambjental dhe proces verbalit përkatëse, të trajtuara si më poshtë:

Më datë 16.04.2016 është autorizuar kryerja e veprimeve të vëzhgimit, filmimeve, fotografimeve ambjentale në lidhje me lëvizjet, takimet dhe mjediset të cilat frekuentojnë të pandehurit [...], [...] dhe [...], me afat 15 ditor. Ndër vëzhgimet e kryera, veçohen.

Sipas procesverbalit të vëzhgimit datë 16.04.2016, grupet e vëzhgimit janë vendosur në aksin rrugor Tiranë-Njësia Administrative [...], në afërsi të bar restorant “[...]”. Është konstatuar mjete i markës “Fuoristradë GL” me targë [...] me ngjyrë të zezë, i parkuar përpara zyrës së shitjes të subjektit “[...]” sh.p.k. Në ambjentet e lokalit janë konstatuar pesë persona, një ndër ta i pandehuri [...]. Personat kanë pasur në tavolinë dokumenta dhe blloqe me ngjyrë të verdhë dhe kanë biseduar rreth tyre.

Procesverbali i vëzhgimit datë 20.04.2016, ku grupi i vëzhgimit i vendosur në afërsi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ka konstatuar të pandehurit [...] dhe [...] rreth orës 10.30, duke dalë së bashku nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Procesverbali i vëzhgimit datë 22.04.2016, sipas të cilit rreth orës 11.20, i pandehuri [...] dhe një person rreth moshës 55 vjeç futen në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke dalë nga atje me dokumenta në dorë në orën 11.57.

Me autorizimin datë 01.05.2016 me afat 15 ditor është autorizuar kryerja e veprimeve të vëzhgimit të të pandehurve [...], [...], [...].

Me autorizimin datë 15.05.2016 me afat 15 ditor është autorizuar kryerja e veprimeve të vëzhgimit të të pandehurve [...], [...], [...] si dhe zyrtarit të lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Procesverbali i vëzhgimit datë 24.05.2016, sipas të cilit në orën 15.30 janë parë duke u futur në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të pandehurit [...] dhe [...]. Në orën 15.45 ato dalin jashtë dhe ka qënë me to dhe i pandehuri [...], përgjimi i orës 15.41.40 [...] i flet me [...] Ballën për procedurën e tenderit të anuluar.

Procesverbali i vëzhgimit datë 25.05.2016, sipas të cilit është konstatuar të dalë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i pandehuri [...], i cili nën shoqërinë e një personi tjetër janë futur në bar restorant “[...]”. Në orën 12.33 është konstatuar i pandehuri [...] përpara godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me një dosje ngjyrë blu në dorë. Futet në ambjentet e brendshme të godinës dhe në këtë kohë fliste në telefon, kjo përkon me komunikimin telefonik të orës 12.07.55 ndërmjet të pandehurit [...] dhe [...]. Në orën 12.48 me automjetin e tij me targë [...] parkon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i pandehuri [...] futet në ambjentet e brendshme të godinës dhe del në orën 12.54. Në orën 13.00 futet në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i pandehuri [...] dhe del në orën 13.20, duke hipur në mjetin [...] me targë [...] me drejtues një person rreth [...] vjeç. Në orën 14.05, automjeti vihet re i parkuar para bar restorant “[...]”. Në brendësi të lokalit vihet re i pandehuri [...] dhe shtetasi drejtues i mjetit me të cilin lëvizën. Në orën 14.14, konstatohet në afërsi të godinës së D.P. Burgjeve i pandehuri [...] dhe takohet me një person rreth 31 vjeç dhe ulen në kafe “[...]”. Në orën 14.28 i pandehuri [...] dhe personi që e shoqëronte ngrihen nga tavolina dhe lëvizin me mjetin “[...]” me targë [...]. Në orën 14.30 i pandehuri [...] dhe personi rreth [...] vjeç dalin nga ambjentet e brendshme të lokalit “[...]” dhe qëndrojnë në këmbë duke biseduar afër D.P. Burgjeve, personi qëndroi në lokal. Ndahen në orën 14.35 dhe i pandehuri [...] hyn në ambjentet e “[...]”. Në orën 14.45 mjete me targë [...], ndalon sa kalon terminalin e pasagjerëve në [...], takon dikë i pandehuri [...] dhe marrin autostradën [...] - [...], ku qënia në [...] e të pandehurit [...] përputhet me rezultatin e përgjimit telefonik datë 25 ora 14.11.13 ndërmjet të pandehurit [...] dhe [...]. Në orën 14.50 i pandehuri [...] del nga ambjentet e bankës “[...]”. Në orën 15.42 automjeti ku gjendej i pandehuri [...] me targë [...], ndalon pranë [...] ku futet i pandehuri. Në orën 15.47 në lokalit “[...]” shkon i pandehuri [...] ku e priste i pandehuri [...] dhe një person rreth [...] vjeç, ata ngrihen nga lokali në orën 16.16. Në orën 15.50 del nga godina e D.P. Burgjeve i pandehuri [...]

dhe me të njëjtin mjet me targë [...], dhe drejtues, zbret dhe hyn në restorant “[...]”. Në orën 16.25 dalin nga automjeti me targë [...] të pandehurit [...] dhe [...], përpara restorant “[...]”, ndërsa shoferi vijojë të qëndrojë në makinë. Presin rreth dy minuta dhe del nga restoranti i pandehuri [...] me një çantë në krahë. Qëndrojnë në këmbë duke biseduar rreth 5 minuta. Në orën 16.33 të pandehurit [...] dhe [...] ndahen nga i pandehuri [...], i cili futet sërish në restorant, për të dalë në orën 17.08.

Me autorizimin datë 30.05.2016 me afat 15 ditor është autorizuar kryerja e veprimeve të vëzhgimit, filmimeve, fotografimeve ambjentale në lidhje me lëvizjet, takimet dhe mjediset të cilat frekuentojnë të pandehurit [...], [...], [...] dhe [...].

Sipas procesverbalit të vëzhgimit datë 06.06.2016 grupet e vëzhgimit janë vendosur pranë godinës së D.P.Burgjeve. Në orën 12.00 është futur në ambjentet e kësaj drejtorie i pandehuri [...] del nga mjeti me targë [...] dhe drejtuesi, shtetasi rreth [...] vjeç, [...]. Më tej, janë vëzhguar të pandehurit [...] dhe [...], të ulur në kafe “[...]” në rrugën e [...], si dhe personi rreth [...] vjeç, i cili lëviz zakonisht me mjetin me targë [...]. Ky i fundit futet dhe merr një [...] tek automjeti që ka qënë i parkuar.

Sipas procesverbalit të vëzhgimit datë 08.06.2016 i pandehurin [...] në orën 07.40 së bashku me një person tjetër të moshës rreth [...] vjeç kanë lëvizur në këmbë në drejtim të vendit ku ka banesën i pandehuri [...], duke u ulur në kafenenë ngjitur me hyrjen e pallatit. Në tavolinën ku janë ulur ka qënë, i pandehuri [...] si dhe një person rreth moshës [...] vjeç me [...], të cilin grupet e vëzhgimit e kanë parë të lëvizë me automjetin “[...]” me targë [...]. Janë ndarë në orën 08.45 dhe i pandehuri [...] është futur në shkallën e pallatit ku ka banesën, ndërsa i pandehuri [...] futet së bashku me personin rreth [...] vjeç në automjetin tip “[...]”, më të cilin ndahet në orën 08.50. Në orën 10.35 është konstatuar se, i pandehuri [...] ka hyrë në godinën e [...] dhe ka dalë në orën 10.45. Në orën 10.57 ka hyrë në godinën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i pandehuri [...], duke dalë në orën 11.20.

Sipas procesverbalit të vëzhgimit datë 09.06.2016, grupet e vëzhgimit kanë evidentuar se, në orën 10.00, hyn në godinën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i pandehuri [...], pasi zbret nga mjeti me targë [...]. Në orën 11.35 konstatohet mjeti tip “[...]” me ngjyrë gri, me targë [...] në aksin rrugor [...], në afërsi të fshatit [...], me dy persona. Drejtuesi automjeti personi rreth [...] vjeç dhe pasagjer në vendin e parë i pandehuri [...]. Automjeti parkohet në rrugën e “[...]” ku zbret i pandehuri [...] dhe personi i moshës [...] vjeç, me flokë [...] dhe me këmishë [...]. I pandehuri [...] hap bagazhin e mjeti dhe vendosur disa [...] në bagazh. Në orën 12.30 ulen të dy në lokalin “[...]” fillimisht i pandehuri [...] dhe pas disa minutash personi rreth [...] vjeç, me flokë [...] dhe këmishë [...]. Në orën 13.40 ngrihen nga lokali dhe hipin në mjetin tip “[...]” me ngjyrë gri, me targë [...], duke parkuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, ku i pandehuri [...] hyn në ambjentet e brendshme të bankës “[...]”. Prej atje del në orën 14.10 me një dosje të bardhë në dorë dhe me të njëjtin mjet vijojnë lëvizjen në rrugën “[...]”, rrugën “[...]”. Zbresin nga automjeti dhe hyjnë në një banesë. Në orën 15.00 dalin dhe vijojnë rrugën e kthimit drejt autostradës [...] - [...] me mjetin tip “[...]” me ngjyrë [...] me targë [...]. Në orën 15.00 nga mjeti zbret i pandehuri [...], përballë “[...]”, duke qëndruar në këmbë rreth 20 minuta. Në orën 15.45 takohet me dy persona, afërsisht [...] dhe [...] vjeç. Në orën 15.55, i pandehuri [...] ndahet prej tyre dhe ata largohen, personi rreth [...] vjeç në mjetin me targë [...] dhe personi rreth [...] vjeç në mjetin me targë [...]. Në orën 20.56, në brendësi të kompleksit të pallateve “[...]”, i parkuar i ndezur, është konstatuar mjeti me targë [...]. Në vendin e shoferit ka qënë një person rreth [...] vjeç, ndërsa në pjesën e pasme të automjetit janë vënë re: personi rreth [...] vjeç që është i njëjti që kishte qënë me të pandehurin [...] në [...] dhe i pandehuri [...]. Kanë biseduar rreth dy minuta pas automjetit kanë lëvizur në këmbë drejt rrugës kryesore, duke u kthyer sërish në brendësi të kompleksit “[...]”. Në orën 21.05, i pandehuri [...] futet në ambjentet e brendshme të pallatit ku jeton, ndërsa personi rreth [...] vjeç hipën si drejtues në mjetin me targë [...], me pasagjerin personin rreth [...] vjeç.

64. Vendimet e gjykatës me të cilat janë caktuar masat e sigurimi, si dhe proces verbalët përkatësë ku është pasqyruar zbatimi i vendimeve të gjykatës, për të pandehurin [...]. Me

vendimin nr. 206 datë 11.07.2016, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”. Ky vendim është ekzekutuar më datë 11.07.2016, referuar aktit “Procesverbal mbi ekzekutimin e vendimit” të kësaj date, ora 21.00. Me vendimin nr.222, date 13.07.2016 gjykata ka verifikuar kushtet e zbatimit të masës së sigurimit “arrest ne burg”, duke mos e ndryshuar masën e dhënë. Me vendimin nr. 86, date 27.07.2016, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tirane ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nr. 206 datë 11.07.2016.Gjatë vijimit të gjykimit, me vendimin 46 datë 07.04.2017, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka ndryshuar vendimin datë 09.03.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë që ka rrëzuar kërkesën e të pandehurit [...] për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg“ në “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore“, duke iu zëvendësuar masa e “arrestit në burg” me masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi“.

65.Vendimet e gjykatës me të cilat janë caktuar masat e sigurimi, si dhe proces verbalet përkatëse ku është pasqyruar zbatimi i vendimeve të gjykatës për të pandehurin [...]. Me vendimin nr. 208 datë 11.07.2016, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”. Ky vendim është ekzekutuar më datë 11.07.2016, referuar aktit “Procesverbal mbi ekzekutimin e vendimit” të kësaj date, ora 20.05. Me vendimin nr.226, datë 13.07.2016 gjykata ka verifikuar kushtet e zbatimit të masës së sigurimit “arrest ne burg”, duke mos e ndryshuar masën e dhënë.Me vendim nr. 87, date 27.07.2016, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë nr. 208 datë 11.07.2016.Me vendimin nr. 225 datë 01.12.2016, Gjykata për Krime të Rënda ka zëvendësuar masën e sigurimit arrest në burg”, duke caktuar ndaj tij masën e sigurimit “arrest në shtëpi”.

66.Vendimet e gjykatës me të cilat janë caktuar masat e sigurimi, si dhe proces verbalet përkatëse ku është pasqyruar zbatimi i vendimeve të gjykatës për të pandehurin [...].Me vendimin nr. 205 datë 11.07.2016, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”. Ky vendim është ekzekutuar më datë 11.07.2016, referuar aktit “Procesverbal mbi ekzekutimin e vendimit” të kësaj date, ora 20.00. Me vendimin nr.225, date 13.07.2016, gjykata ka verifikuar kushtet e zbatimit të masës së sigurimit “arrest ne burg”, duke mos e ndryshuar masën e dhënë.Me vendim nr.84, date 27.07.2016, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tirana e ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nr. 205 datë 11.07.2016.Me vendimin nr. 230 datë 12.12.2016, Gjykata për Krime të Rënda ka zëvendësuar masën e sigurimit “arrest në burg”, duke caktuar ndaj tij masën e sigurimit “arrest në shtëpi”.

67. Vendimet e gjykatës me të cilat janë caktuar masat e sigurimi, si dhe proces verbalet përkatëse ku është pasqyruar zbatimi i vendimeve të gjykatës për të pandehurin [...].Me vendimin nr. 209 datë 11.07.2016, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”. Ky vendim është ekzekutuar më datë 11.07.2016, referuar aktit “Procesverbal mbi ekzekutimin e vendimit” të kësaj date, ora 18.30. Me vendimin nr. 224, datë 13.07.2016 gjykata ka verifikuar kushtet e zbatimit të masës së sigurimit “arrest ne burg”, duke e ndryshuar masën e dhënë në “arrest në shtëpi”.Me vendim nr. 224, date 30.07.2016, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka miratuar vendimi e Gjykates së Shkalles së Parë për Krime të Rënda.

68.Vendimet e gjykatës me të cilat janë caktuar masat e sigurimi, si dhe proces verbalet përkatëse ku është pasqyruar zbatimi i vendimeve të gjykatës për të pandehurin [...].Me vendimin nr. 207 datë 11.07.2016, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”. Ky vendim është ekzekutuar më datë 11.07.2016, referuar aktit “Procesverbal mbi ekzekutimin e vendimit” të kësaj date, ora 20.00. Me vendimin nr.223, date 13.07.2016 gjykata ka verifikuar kushtet e zbatimit të masës së sigurimit “arrest ne burg”, duke caktuar si masë sigurimi “arrest në shtëpi”.Me vendim nr.92, date 30.07.2016, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë nr. 223, datë 13.07.2016, duke caktuar si masë sigurimi personal me karakter shtërngues ndaj të hetuarit [...] “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”.

69. Vendimet e prokurorit për njoftimin i akuzave, nga ku rezulton si më poshtë:

a. Të pandehurit [...] me vendimin për njoftimin e akuzës, datë 07.09.2016 i është njoftuar akuza për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë” më shumë se një herë, parashikuar nga neni 260, 50/h të K. Penal si dhe “Mbajtjes pa leje të armëve dhe municionit luftarak në banesë”, parashikuar nga neni 278/3 i K. Penal.

b. Të pandehurit [...] me vendimin për njoftimin e akuzës, datë 05.09.2016 i është njoftuar akuza për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë”, parashikuar nga neni 245 dhe 25 K. Penal.

c. Të pandehurit [...], me vendimin për njoftimin e akuzës, datë 07.09.2016 i është njoftuar akuza për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë”, më shumë se një herë, parashikuar nga neni 245, 25, 50 të K. Penal.

d. Të pandehurit [...], me vendim për njoftimin e akuzës, datë 05.09.2016 i është njoftuar akuza për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë”, parashikuar nga neni 245 dhe 25 të K. Penal.

e. Të pandehurit [...], me vendim për njoftimin e akuzës, datë 07.09.2016 i është njoftuar akuza për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë”, më shumë se një herë, parashikuar nga neni 245, 25, 50 të K. Penal.

70. Vendimi nr.70 datë 19.09.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, vendim i marrë gjatë gjykimit në apel, konformë kërkesave të nenit 427/2 të K.Pr.Penale me kërkesë të pandehurve dhe mbrojtësve, në kushtet, kur ky vendim ishte marrë, pasi ishte gjykuar çeshtja në shkallë të parë, dhe ndikonte në vendimarrjen e gjykatës, sepse të pandehurit akuzohen që kanë dhënë mitëpër llogari të gjykuarit më vete, ish Drejtorit të Përgjithëshme të Burgjeve z. [...], lidhur me tenderin datë 31.05.2018. Sipas vendimi nr.70 datë 19.09.2018, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr. 64 datë 11.05.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë si më poshtë:

a. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit [...], për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 e 25 i K. Penal, pasi nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën për të cilën akuzohet.

b. Referuar nenit 389 të K.Pr.Penale urdhërohet lirimi i të pandehurit [...] nga paraburgimi, nëse nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër.

Pra, në këtë rast, pas kësaj vendimarrje ka rënë dhe bashkëpunimi me zyrtarin e lartë, sepse personi që ka qënë zyrtar i lartë është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë, e për pasojë provohet vetëm fakti që marrja e parave është bërë nga i pandehuri [...] që është zyrtar publik me statusin e nëpunësit civil, dhe nuk provohet që këto para ti ketë marrë zyrtari i lartë, ashtu siç ka qënë akuza. Në këto kushte bien akuza e korrupsionit pasiv e aktiv të zyrtarit të lartë, parashikuar nga nenet 260 e 245 të K. Penal.

B. Deklarimet e dëshmitarëve dhe të pandehurve:

1. Dëshmitari [...] në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se: “Gjatë periudhës maj, qershor 2016 ka qënë i punësuar në Drejtorinë e Përgjithëshme të Burgjeve, me detyrën e përgjegjës të sektorit të burimeve njerëzore. Deri në Janar të vitit 2016 ka qënë përgjegjës i sektorit të prokurimeve po në këtë drejtori. Fillimisht shpjegon procedurën që ndiqet gjatë prokurimit pa shpallje paraprake të kontratës në rastet e furnizimeve me ushqime. Nevoja për të proceduar në këtë mënyrë, vjen nga sektori i logjistikës, i cili informon drejtorin mbi nevojat. Duke përllogaritur afatin e nevojshëm që do një procedurë normale tenderimi, përcaktohet dhe çfarë lloj procedure do ndiqet (procedura e hapur apo me negociim pa shpallje, apo të dyja paralelisht). Sektori i prokurimeve përcakton nëse ka kohë të mjaftueshme për të bërë një procedurë të hapur ose jo dhe kjo në varësi të situatës. Propozimet ky sektori ia dërgon titullarit, pra Drejtorit të Përgjithëshëm të Burgjeve, si titullari i autoritetit kontraktor nëpërmjet një memoje, që sipas dëshmitarit, përgjithësisht është formal. Komisioni i vlerësimit

të ofertave përcaktohet nga titullari i njësisë së prokurorit.....subjektet, apo operatorët që ftohen për të marrë pjesë në një procedurë prokurori pa shpallje, janë ato operatorë të cilët kanë pasur historik në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për shkak se kanë pasur një kontratë të mëparshme, apo dhe aktuale. Ftohet gjithashtu dhe operatori i cili ka kontratën në fuqi..... përgjithësisht ka qenë detyrë e sektorit të prokurimeve, i cili dhe e di se me kë ka pasur kontrata në historik, dhe ia propozon me memo drejtuesit.Njoftimi i operatorëve bëhet me shkresë zyrtare, në rast se ka kohën të nevojshme, por dhe me telefon dhe subjektet shkojnë dhe tërheqin shkresën pranë protokollit ku marrin dhe të gjithë dokumentacionin që duhet për të paraqitur në tender... Përsa i përket dokumentit të përgatitur në fund të procedurës nga komisioni i përcaktimit të fondit limit, dëshmitari u shpreh se ka pasur raste që nuk ka qenë i miratur nga nëndrejtori, por vetëm nga drejtori, sikurse ka pasur raste që miratimi ka qenë nga të dy.Sektori i logjistikës, sipas dëshmitarit, në kohën për të cilën u pyet, është kontrolluar nga zëvendës drejtori i përgjithshëm i burgjeve, [...], por nuk është në dijeni nëse ka pasur një urdhër me shkrim për këtë gjë.”

2.Dëshmitaria [...]në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se: “Lidhur me procedurën e tenderimit të datës [...], me urdhër të drejtorit, pasi i është drejtuar atij sektori përkatës, në rastin konkret ai i i logjistikës, i cili merret me furnizimin me ushqime, është krijuar dhe komisioni i përcaktimit të fondit limit, në përbërje të të cilit është caktuar dhe ajo.Më tej dëshmitarja shpjegon procedurën e ndjekur nga komisioni për përcaktimin e fondit limit, konkretisht duke iu referuar udhëzimeve të ligjit “Mbi prokurimin”, të dhënave të Instatit, të tregut ose të kontratave të mëparshme.Përlllogaritja e fondit limit i dërgohet nëpërmjet një memoje dhe një relacioni shpjegues eprorëve, zëvendës drejtorit, në atë kohë [...] dhe më pas drejtorit, në atë kohë [...]. Sektori i financës, e logjistikës, çfarë lidhet me anën ekonomike ishin pjesë e deleguar osë e varësisë së zëvendës drejtorit dhe pjesa ligjore ka qenë nën varësinë e zëvendës drejtorit tjetër.Lidhur me ftesën që iu bëhet operatorëve për të marrë pjesë në procedurën pa shpallje paraprake, kjo i përket sektorit të prokurimit.”

3.Dëshmitarja [...], në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se:“Lidhur me aktin përfundimtar, [...], të përgatitur nga komisioni i përcaktimit të fondit limit lidhur me procedurën e tenderimit të datës 31.05.2016, në përgjithësi e kemi kaluar tek zëvendës drejtori [...], që mbulonte anën ekonomikedhe nëpërmjet tij e dërgonin tek drejtori..... nuk kishte ndodhur ndonjëherë, por mund t’a rikthente.....se tenderi nuk kishte pasur të veçanta dhe se nuk kishte pasur ndërhyrje, pasi zakonisht vepronin në rrugë shkresore.....Mallrat i kontrollojnë në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat fillimisht bëhen hyrje provizore nga magazinieri sipas kontratës dhe më tej komisioni i numëron, i vlerëson, duke u marrë dhe me anën teknike të secilit artikull.Nuk janë të detyruar që operatorët të jenë prezent në momentin e marrjes në dorëzim, nuk ka nevojë për firmën e tyre por i çon njoftim zyrtar nëse ka ndonjë problem. Rasti konkret nuk i kujtohet, por ajo së bashku me [...]n kanë qenë të dy në komision dhe kanë bërë të njëjtën punë.”

4.Dëshmitari [...],në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se:“.....komision përgatit një memo dhe një procesverbal për mënyrën sesi është vepruar për t’u përcaktuar fondi limit dhe i dërgohet nëndrejtorit të përgjithshëm, i cili mbulon atë sektor, dhe anën ekonomike. Ai e studion, e miraton dhe pastaj e përcjell tek drejtori i përgjithshëm i burgjeve.Ka pasur raste që si nëndrejtori, ashtu dhe drejtori i kanë kthyer mbrapsht memot dhe praktikën e komisionit pasi e tillë është procedura. Në rastin në fjalë procedura e këtij komisioni nuk është kthyer mbrapsht prej tyre.”

5.[...]në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se: “Lidhur me procedurën e tenderimit të datës 31.05.2016, ka qenë juriste e komisionit të hartimit të dokumentave të tenderit..... ajo zhvillohej pas anulimit të tenderit të D.P.Burgjeve nga Komisioni i Prokurimit Publikpas ankimimit të njërit prej operatorëve pjesëmarrës.për shkak të urgjencës plotësoheshin kushtet për t’u zhvilluar një procedurë tenderi me negociim pa shpallje paraprake të kontratës, derisa të zhvillohej një procedurë e hapur në sistemin elektronik të prokurimeve, pasi, sipas dëshmitares mbetej një periudhë prej dy muaj e pa

mbuluar me produkte ushqimore. Detyrë e komisionit të hartimit të dokumentave të tenderit ka qenë dhe njoftimi i operatorëve ekonomik, përzgjedhja e tyre. Njoftimi i operatorëve, normalisht bëhej me shkresë, por për shkak të afateve të limituara është bërë dhe në rrugë telefonike, me qëllim tërheqjen e njoftimeve në formë shkresore dhe marrjen e dokumentacionit të plotë që duhet të plotësonin për të paraqitur ofertat....komisioni i hartimit të dokumentave të tenderit ka rënë dakort që të përzgjidhen të gjithë operatorët ekonomikë, të cilët në vite kanë pasur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurat e prokurorimit të zhvilluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Në këtë përzgjedhje ata si komision nuk kanë pasur ndërhyrje nga titullarët dhe asnjë njohje personale me operatorët. Nuk e njeh të pandehurin [...] dhe e ka parë për herë të parë në gjykatë.”

6.*Dëshmitarët [...] dhe [...], në seancë gjyqësore ndër të tjera kanë deklaruar se: “.... janë thirrur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe se procedurat e këtij tenderi janë mbyllur brenda ditës, pasi ka qenë një tender që duhej përfunduar shpejt. Komisioni nuk ka kontakt me operatorët dhe fillimisht kualifikohen ata që plotësojnë kriteret e dokumentacionit. Janë skualifikuar për mungesë dokumentacioni të gjithë operatorët dhe është kualifikuar vetëm operatori “[...]” sh.p.k, përfaqësuesit të të cilit [...] i është kërkuar fotografi për të verifikuar një automjet, nëse ishte i përshtatshëm, nëse ishte vërtetë mjet [...]. Më tej është shpallur ai fitues, duke u lidhur dhe kontrata. E gjithë procedura ka vijuar nga ora 14.00 deri në orën 20.00. Nuk kanë debatuar me përfaqësuesit e operatorëve dhe posaçërisht nuk kanë debatuar me shtetasin [...].....”*

7.*Dëshmitare [...], në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se: “Ka qenë [...] në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve deri në Shtator të vitit 2016. Në muajin Maj të këtij vitit kishte marrë pjesë në një komision për marrjen e mallrave ushqimorë në dorëzim. Anëtare komisioni kishte qenë dhe [...] dhe kryetar komisioni [...]. Malli, sipas dëshmitares është marrë në dorëzim i shoqëruar me dokumentacion të rregullt dhe nuk ka vërejtur dhe nuk ka pasur asnjë parregullsi. Mallrat që dorëzoheshin kishin të bënin me tenderin e fituar nga subjekti “[...]” sh.p.k. Anëtarët e komisionit ishin mbledhur të tre vetëm në momentin e kolaudimit të mallit dhe sipas dëshmitares përfaqësuesit e subjektit nuk janë të detyruar të jenë prezent kur dorëzohet malli. Ka kontaktuar për të bërë rakordimin e orareve të furgonave që sillnin mallin për ta magazinuar.”*

8.*I pandehuri [...] në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se: “Në muajin [...], kur dhe është arrestuar, ka qenë [...] i përgjithshëm i burgjeve, funksion që e mbante prej gjastë apo shtatë vitesh. Fillimisht ka qenë i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, ku mbulonte drejtorinë e personelit, të financës dhe logjistikës. Me një vendim tjetër, në mars të vitit 2015, në ndryshim të rregullores së përgjithshme të burgjeve, roli është kufizuar në delegimin e detyrave nga drejtori i përgjithshëm.... Nga ky moment roli ka qenë më tepër honorifik për të plotësuar burokracinë e institucionit..... Lidhur me procedurën e tenderimit të datës 31.05.2016 drejtori [...] e ka thirrur në zyrë dhe e ka vënë në dijeni të kësaj procedure. I ka thënë se të takonte zotin [...], sepse me të kishte biseduar ai dhe prej tij do të merrte pagesën prej 10% të vlerës së tenderit, ose vlerën prej dy milionë lekë të reja. Me [...] Kalanë njihej për shkak të kontakteve të punës, referuar delegimit të drejtorit të përgjithshëm ku mbulonte dhe sektorin e logjistikës dhe për pasojë është njohur me operatorët që operonin në D.P. Burgjeve. Njohja ka qenë thjesht pune, me takime të rralla. Lidhur me porosinë e marrë nga drejtori ka takuar rreth dy-tre herë dhe ka komunikuar në telefon me të pandehurin [...]. Ai ka qenë i mërzitur lidhur me vlerën e kërkuar nga drejtori se normalisht i ka pasur dokumentat e rregullta dhe nuk mendonte se duhet të paguante. [...] iu kërkonte 20%, por ata nuk i paguanin dot këtë vlerë. Në biseda [...] i ka thënë se kishte diskutuar me [...] n dhe e ka siguruar, duke i thënë mos të kishte merak sepse do ta bënin pagesën..... rënie dakort për shifrën 10% e kishte bërë [...] [...] me [...] dhe se ai ishte vetëm përçues i porosisë së [...] dhe marrësi i parave... janë telefonuar disa herë, e është realizuar takimi në [...] ku [...] i kishte dërguar zotin [...]. Ky i fundit nuk kishte qenë pjestar në këtë proces, por [...] i kishte thjesht shok. Nuk kishte dijeni rreth operatorëve që do të merrnin pjesë në tender, pasi drejtori i*

zgjidhte vetë operatorët. Takimi ndërmjet tij dhe të pandehurit [...], ku ky i fundit i kishte dorëzuar vlerën prej [...] lekë ishte bërë në zonën e [...], afër “[...]”, afër “[...]”. [...], i cili ka qenë i vetëm, i kishte thënë se kjo ishte porosia e [...] për [...] [...]n, dhe pasi i ka marrë lekët ka shkuar në zyrën e [...] [...]pas rreth gjysëm ore, një ore. Ai po e priste në zyrë. Paratë nuk i kishte numëruar, por kishte hapur pjesën e mbështjellëses dhe ato kishin qenë të mbështjella me [...]banke, kishte parë katër prerje me të shkruar [...] të reja. Pasi ia ka dhënë vlerën në lekë ai i ka thënë, mos u mërzi se kam disa detyrime dhe do të sistemoj dhe ty, duke nënkuptuar se do t’i jepte një pjesë të vogël dhe atij, por që në fakt nuk i kishte dhënë. Nuk ishte në dijeni të vlerës që mund t’i jepte [...], pasi nuk e kishte pyetur, por ndonjë duhet të ishte, sipas tij ndonjë vlerë e vogël..... [...] e njihte si operator ekonomik që merrte pjesë në procedurat e tenderimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Kishte përshëndetje, por me të nuk kishte komunikuar asnjëherë në telefon. As lidhur me vlerën e dorëzuar nga [...]n nuk kishte komunikuar me këtë të pandehur me [...],nuk kishte pasur konflikte, apo debate me të dhe se nuk i kujtohej t’i kishte kërkuar diçka nuk e mbante mend, se dorëzimi është bërë para datës 31.05.2016 por ato ditë kishin qenë, por nuk ishte as në brendësi të datës së tenderit, pasi nuk ishte marrë me atë punë.....ishin lidhur me telefon, pasi me të dhe me [...]in kishte njohje pak më të afërt, se me të tjerët,kishte nënshkruar aktin memo të përgatitur lidhur me procedurën e tenderimit të datës 31.05.2016 nga komisioni i përcaktimit të fondit limitdhe ky ka qenë një veprim burokratik..... Ka të drejtë t’a kontrollojë përmbajtjen e akteve të përgatitura nga komisioni në kuadër të përcaktimit të fondit limit, por ato janë vlera të përcaktuara dhe nuk mund të dilet prej tyre....[...]i më tha që do të vijë [...] të takojë. Kjo ka qenë ideja, prandaj ai po vonohej. Nuk po vinin. Ky tjetri më bënte presion që ku i ke se do ta kthej tenderin mbrapsht,gjatë procedurës së marrjes në dorëzim, përfaqësuesi i subjektit duhet të jetë si rregull prezent, pasi ai paraqet dokumentat. Me të pandehurin [...] lidhur me këtë rast nuk mban mend të ketë komunikuar në telefon dhe nuk di të ketë pasur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet [...] si përfaqësues i subjektit “[...]” me të pandehurin [...].....nga të pandehurit [...] dhe [...] vlerën prej [...]lekë si nuk kishte marrë dhe se ky ishte një proces totalisht i përfunduar, pasi këta, operatorët ekonomikë të përfaqësuar nga të pandehurit, kishin qenë gjithmonë korrekt dhe nuk bëhej fjalë të sillnin mallra jo të standarteve të duhura.....marrëdhënieve .. me [...].... ishin normale, pa kontakte jashtë drejtorisë së përgjithshme të burgjeve.....”

9.I pandehuri [...]në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se: “Ka qenë dhe është përfaqësues i subjektit ekonomik “[...]” SHPK me numër nipti [...] dhe përdorues i numrit të telefonit [...]. Si përfaqësues i këtij subjekti ka marrë një ftesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për të marrë pjesë në procedurën negociim pa shpallje, blerje bulmet dhe vezë me fond limit [...] (diçka e përafërt). Ftesën e ka marrë pranë protokollit, duke u njoftuar fillimisht me telefon. Pesë ditë para datës 31.05.2016, rreth datave 25 apo 26 ka marrë ftesën dhe dokumentat shoqëruese. Ditën e tenderit janë futur brenda në drejtori rreth orës 14.00-14.30 dhe kanë qenë pjesëmarrëse katër kompani, pra kompania e tij, “[...]” sh.p.k, dhe “[...]” sh.p.k, dhe kompania “[...]”. Është skualifikuar nga kjo procedurë për shkak të mospajisjes së mjetit të transportit me certifikatë transporti dhe për këtë skualifikim ka debatuar me anëtarët e komisionit, prandaj dhe procedura ka zgjatur deri rreth orës 19.00. Sipas tij skualifikimi i tij ka qenë i paligjshëm, por kjo procedurë nuk e njuh ankimimin dhe po atë ditë lidhet kontrata. Fitues është shpallur subjekti “[...]” sh.p.k Për tenderin e datës 31.05.2016 nuk ka folur në telefon me të pandehurin [...]. Bisedat telefonike kanë qenë në kuadër të shlyerjes së detyrimeve të mëparshme që ai ([...]i) kishte ndaj tij. Ai ka vazhduar t’i kërkojë këto detyrime, pasi kanë qenë të ardhurat e subjektit të tij për furnizimet që i kishte kryer subjektit që përfaqësonte [...], duke i thënë në telefon që ishte bërë një vit e ca pa i dhënë lekët. Kjo, sipas të pandehurit [...] tregon qartë se nuk bëhet fjalë për tenderin e datës 31.05.2016, por për furnizime të kryera për llogari të subjektit “[...]”, ndërsa ky subjekt kishte kontratë furnizimi dy vjet më parë me [...]. Detyrimi i kompanisë “[...]” ndaj kompanisë së tij ka qenë 4.2 milionë lekë, ku ai kishte kryer furnizime për këtë subjekt dhe nuk kishte marrë vlerën. Likujdimi ka qenë pjesor, pasi dhe

pjesor ka qenë likujdimi i [...]ndaj subjektit që përfaqësonte [...].Dhe i pandehuri [...] kishte detyrime të pashlyera ndaj tij, fatura të furnizimeve të mëparshme, dhe për këtë i ka thënë në telefon [...] Laskës t'i jepte atij dy milionë lekë për faturat e pashlyera të tij si dhe një vlerë për llogari të [...], por [...]i nuk ia kishte dhënë. Më vonë i ka likujtuar [...] vlerën prej [...] lekë nëpërmjet bankës, vlerë e përfaqësuar e detyrimit që ai i kishte rreth datave 15 ose 16 Qershor 2016.Nuk ka pasur marrëveshje paraprake ndërmjet tyre (subjekteve pjesëmarrëse në këtë tender) që nëse do të fitonte ndonjëri tenderin e datës 31.05.2016, të tjerët do të ishin në rolin e furnitorit të tij. Më pas, subjekti fitues që i interesuar dhe kanë rënë dakort për çmimin e furnizimit, ai si shitës dhe fituesi si blerës dhe ashtu kishin vijuar. Të pandehurin [...] e njeh duke qenë ai në pozicionin e [...] të përgjithshëm të burgjeve. Është takuar me të rreth periudhës prill - maj 2016 dhe kjo lidhur me një procedurë [...] që ai kishte me këtë drejtori. E ka paraqitur këtë procedurë në gjykatë dhe e ka fituar. Takimi me [...]n ka qenë i detyruar për të paraqitur raportin e ankimimit ndaj kësaj procedure dhe takimi ka qenë rreth një muaj më parë sesa data 31.05.2016, kur është zhvilluar dhe tenderi. Me [...]n shprehet se dhe ka komunikuar me telefon dhe kjo për shkak të problemeve që mund të kishte furnizimi me gaz të lëngshëm në institucionet e varësisë në D.P.Burgjeve.....shkaku i takimit më datë 25.05.2016 me të pandehurin [...], duke qenë ai së bashku me të pandehurin [...] ka qenë procedura e gazit dhe punësimi prej tij i shtetasit me emrin [...], në firmën e tij për furnizime të ndryshme. Ka qenë në rolin e furnitorit, furnizuesit ndaj subjektit “[...]” sh.p.k, më përfaqësues [...] Kalanë, pasi subjekti i tij kishte fituar një tender me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Mallin ia dorëzonte [...] me cilësinë e furnitorit, në vendet ku i ishte caktuar në kontratë, dhe nuk kishte pse të lidhej me [...]n, madje shprehet nuk është pajtuar me komunikimin telefonik që [...] i thoshte: “Më kollaj është të takosh kryeministrin sesa ty”. [...] mund dhe ta këtë marrë në telefon për të shkuar dhe marrë në dorëzim mallin, për të cilin ai kishte furnizuar subjektin “[...]”, që kishte marrëdhënie me D.P.Burgjeve, por ai nuk kishte vajtur dhe nuk kishte pse të shkonte pasi marrëdhënien e kishte me [...] dhe malli ka qenë konform të gjithë parametrave. Nuk ka qenë pjesë e kompromisit për të cilin akuzohet përderisa ka debatuar me anëtarët e komisionit për skualifikimin e subjektit që ai përfaqësonte, gjithsesi shprehet se fituesi i tenderit të datës 31.05.2016, “[...]” sh.p.k e ka fituar atë konform ligjit.”

10.I pandehuri [...]në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se: “Ka administruar në vitin 2016 subjektin “[...]” sh.p.k por nuk e administron aktualisht. Ka përdorur dhe përdorur dhe aktualisht numrin e telefonit [...].....në procedurën e tenderit të datës 31.05.2016 të zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka pasur ftesë për pjesëmarrje, por nuk ka pasur interes për të marrë pjesë.Nuk ka biseduar me asnjë prej të pandehurve të tjerë, përfaqësues të operatorëve që kanë marrë pjesë në këtë tender. Nuk është në dijeni nëse procedura e tenderit në fjalë ka qenë e rregullt apo jo.Ditën që është zhvilluar tenderi shprehet se nuk i kujtohet të ketë qenë në ambjentet e drejtorisë së burgjeve, por pas tenderit janë takuar, ai, [...],i, [...],u, [...] dhe kishin drekuar bashkë dhe kjo nuk ishte e vetmja herë, pasi ata takoheshin shpesh për kafe e dreka.Të pandehurin [...] e ka njohur si nëndrejtor i përgjithshëm i burgjeve, pasi me këtë [...] ka pasur kontrata të tjera dhe nuk ka pasur njohje të tjera me të. E ka takuar atë për probleme punë, mesa i kujtohet vetëm një herë jashtë zyrës së tij, diku tek ish-blloku, tek “[...]” apo “[...]”. Me sa i kujtohet ky takim ka qenë para datës 31.05.2016. E ka takuar sepse ai i kishte dërguar disa mesazhe duke kërkuar të shkonte ta takonte, ndërsa ai i ka thënë se këto mesazhe nuk janë për të dhe nuk kishte pse e takonte. Ka shkuar e ka takuar pasi është ndjerë i habitur nga këto mesazhe. Kishte qenë së bashku me [...]n, me të cilin po atë ditë kishin qenë në [...], po për probleme pune.Në takim [...] kishte pyetur si po shkonte me kontratat që kishte me drejtorinë e burgjeve dhe ai i ishte përgjigjur se punët shkonin normalisht.Nuk i ka dhënë para as [...]t dhe as dikujt tjetër për të fituar tendera në këtë drejtori.Të pandehurit [...] Laska, [...], [...] i njeh vetëm se ka pasur marrëdhënie pune, si operatorë të të njëjtit aktivitet.....nuk i kishte kërkuar të pandehurit [...] të shkonte të takonte të pandehurin [...].....[...] kishte vajtur dhe e kishte takuar [...]n për problemet e veta të furnizimit me gaz, për shkak të kontratës që kishte me drejtorinë e burgjeve.....nuk i është

kërkuar që të ishte prezent në momentin që komisioni do të merrte në dorëzim mallrat, pasi dhe malli ka qenë konform rregullave me fletë analize.....nuk dinte gjë dhe se nuk i kishte kërkuar gjë [...] dhe se çdo gjë e kishin bërë sipas ligjit.....deklarimeve të dhëna në fazën e hetimit, i ka bërë duke qenë në kushtet e presionit psikologjik, pasi i është thënë se do të kalbej në burg dhe nuk do ta shihte familjen. Nuk i kujtohej se kush e kishte marrë në pyetje, por pyetja ishte bërë në Prokurori. Këto deklarime i ka firmosur pa i lexuar dhe se avokati kishte qenë aty. Rreth muajit shtator kishte bërë deklaratën noteriale që e kishte depozituar dhe në protokollin e prokurorisë ku shprehte faktin se këtë deklaratë e kishte nënshkruar në kushte presioni.”

Konform nenit 370/1 të K.Pr.Penale, mbi kërkesën e prokurorisë nga gjykata është lejuar kundërshtimi tërësisht i përmbajtjes së deklarimeve të të pandehurit [...], me e deklarimet të bëra prej tij gjatë hetimeve paraprake të pasqyruara në proces verbalin datë 13.07.2016, ku i pandehuri [...] në prani të mbrojtësit rezultoi të jetë shprehur: *“Shoqëria që ai administronte nuk kishte marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Kjo procedurë ka qenë një procedurë e nisur më parë, por për shkak të ankesave të operatorëve ajo është anuluar. Ka qenë fillimisht një procedurë me shpallje në mënyrë elektronike dhe e ndarë në tre lote. Ka konkuruar në njërin lot dhe e ka fituar. Në të njëjtin kohë është zhvilluar dhe procedura për lotin “[...],[...],[...]”, ku kanë konkuruar dy operatorët “[...]” dhe “[...]” sh.p.k. Është shpallur fituese kjo e dyta dhe subjekti tjetër është ankuar. Pas ankesës është shpallur fituese “[...]” dhe “[...]” është ankuar dhe pas ankesës e gjithë procedura është anuluar. Mbi këtë fakt jemi informuar me shkresë nga D.P.Burgjeve dhe pas disa ditësh janë njoftuar për të marrë pjesë në procedurën prokuruese “negocim pa shpallje” ku shprehet se nuk ka marrë pjesë. Pavarësisht kësaj, ai së bashku me përfaqësuesit e operatorëve të tjerë, [...], [...], [...] janë mbledhur në një lokal dhe kanë diskutuar të përcaktonin midis tyre se cila shoqëri do të fitonte. Kanë rënë dakort që ta fitonte këtë tender subjekti “[...]” sh.p.k me administrator [...]. Pasi kjo shoqëri të shpallje fituese, ata, pra operatorët e tjerë do të ishin nënkontraktorë, duke përfituar kështu dhe ata nga këto fonde. U ra dakort që nënkontraktorët e tjerë do të përgatisnin oferta më të larta se shoqëria “[...]” sh.p.k. Kanë biseduar që përfaqësuesit e drejtorisë së përgjithshme të burgjeve do të kishin përfitimin e tyre material për këtë në masën dy milionë lekë të reja. Për mbledhjen e kësaj shume ai nuk ka vënë pjesë, por këtë e kishin mbledhur tre të tjerët dhe vlera i është dërguar zëvendës drejtorit të përgjithshëm të burgjeve, shtetasit [...]. Vlera i është dërguar, në dijeninë e tij nga një nga administratorët e tjerë që kishin marrë pjesë në këtë procedurë, [...], [...] dhe [...].... Pas shpalljes fitues të tenderit të datës 31.05.2016 të subjektit “[...]” shpk ka komunikuar me këta shtetas, pasi vlera për të cilën ishte rënë dakort paraprakisht për të shpërblyer zyrtarët e D.P.Burgjeve, nuk ishte dërguar. Biseda e zhvilluar prej tij ka pasur si qëllim që shtetasit që e kishin marrë përsipër të kryenin këtë shpërblym ta dërgonin këtë shumë.....ka qenë prezent bashkë me [...]n kur ky i fundit kishte marrë në telefon [...], duke i kërkuar që [...]i, i cili kishte marrë përsipër që të dërgonte shumën e sipërcituar shtetasit [...], duke qenë se nuk po i dërgonte, t’ia jepte shtetasit [...] që t’ia çonte ky i fundit. Zyrtari që do të merrte dhe ka marrë shumën prej dy milionë lekë të reja është zëvendës drejtori [...].....me shtetasin [...] ka biseduar dhe në lidhje me një procedurë tjetër, kolaudimi për marrjen në dorëzim të mallrave ushqimorë. Për këtë procedurë do t’i jepte atij një shumë prej [...] lekë të reja. Duke qenë se në këtë procedurë, shtetasi [...] ishte nënkontraktor i tij dhe këtë shumë duhet t’ia paguante ai, dhe pikërisht ai ia kishte dhënë...”*

Deklarime e bëra nga i pandehuri [...] në hetimet paraprake, cituar më sipër janë në unison me deklarimet e të pandehurit [...] si dhe përgjimet telefonike për të dy episodet, për pasojë kolegji i vlerëson ato në harmoni me provat e tjera.

11.I pandehuri [...] në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se: *“Ka administruar në vitin 2016 subjektin “[...]” shpk dhe ka pasur në përdorim numrat e telefonit [...] dhe [...]. Në këtë vit ka pasur të lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve një kontratë “për lotin furnizim me mish”. Njoftimin për të marrë pjesë në tenderin e datës 31.05.2016 e ka marrë nëpërmjet telefonit, nga institucioni, por dhe nga sistemi elektronik i D.P.Burgjeve, ku*

operatorët kishin akses. Materialin për pjesëmarrjen në këtë tender e ka përgatitur vetë. Nga kjo procedurë është eliminuar sepse nuk kishte vënë një vërtetim nga [...] -i, duke replikuar dhe me anëtarët e komisionin. Pasi është ballafaquar me dokumentacionin, ka parë dhe vetë që ky dokument mungonte dhe noterja nuk ia kishte vendosur. Në këtë procedurë, përveç tij (subjektit “[...]” sh.p.k) kanë marrë pjesë katër operatorë, që administroheshin nga të pandehurit [...], [...] si dhe subjekti “[...]”, nuk është i saktë për emrin e këtij subjekti. Me të pandehurit [...], [...], [...] njihet prej kohësh, shumë kohë përpara tenderit për shkak të marrëdhënieve të biznesit dhe për shkak të punës mund të kenë bërë dhe telefonat. Ditën e zhvillimit të tenderit (i pyetur nga gjykata) shprehet se ka shkuar i vetëm në D.P.Burgjeve dhe i ka gjetur në korridor të drejtorisë pjesëtarët e tjerë të kësaj procedure dhe nuk ka pasur takim paraprak me asnjërin prej tyre dhe mesa i kujtohet me asnjërin nuk ka pasur komunikim telefonik. Nuk ka bërë asnjë marrëveshje me ta lidhur me këtë tender, apo për t’iu dhënë vlera monetare drejtuesve të D.P.Burgjeve, të cilët nuk i ka njohur. Të pandehurin [...], nëndrejtorin e ka njohur vetëm kur janë arrestuar. Nuk kanë pasur asnjë marrëveshje paraprake lidhur me procedurën e datës 31.05.2016 ndërmjet tij dhe të pandehurve të tjerë që të kryenin shërbime nënkontraktore nëse ai do të shpallej fitues. Nga i pandehuri [...] ai ka marrë një vlerë prej njëzet milionë lekë të vjetra në kohën që ai ([...]u) kishte shkuar në [...]. [...]u i kishte thënë se .meqenëse dilte çdo ditë në treg, mundësisht kur të jenë punëtorët e mi atje, jepi lekët se nuk iua lë dot punëtorëve të mi [...]lekë dhe kur të vij mbyllim hesapet.”

12.I pandehuri [...], në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se: “Ka administruar në vitin 2016 dhe administron subjektin “[...]” sh.p.k dhe ka pasur në përdorim numrin e telefonit [...]. Fillimisht ky i pandehur shpjegoi se subjekti i përfaqësuar prej tij kishte marrë pjesë së bashku me operatorin “[...]” shpk në procedurën e hapur të tenderit të anuluar prej ankimit të tij dhe duke qenë në dijeni të këtij fakti që kishte mbaruar afati dhe mund të zhvillohej një procedurë tenderimi me negociim pa shpallje. Procedura e re është shpallur më datë 27.05.2016 dhe ka marrë ftesën nga D.P.Burgjeve për të marrë pjesë në këtë procedurë që do të zhvillohej më datë 31.05.2016. Është paraqitur në zyrën e logjistikës dhe ka marrë ftesën dhe dokumentacionin për t’u përgatitur për këtë procedurë. Ka përgatitur dokumentacionin dhe ka dorëzuar fillimisht dokumentacionin ligjor, pastaj sipas procedurës, hapeshin ofertat nëse shpallej fitues tek dokumentacioni. Komisioni i ka kërkuar disa fotografi të makinës frigoriferike, të cilat ia ka dërguar djali në “[...]” dhe është kualifikuar nga komisioni. Në drejtorinë e burgjeve ditën që është zhvilluar tenderi ka shkuar i vetëm dhe ka takuar në korridor [...], [...]n dhe përfaqësuesen e “[...]”. Nuk kishte dijeni më parë që dhe ata do të merrnin pjesë në tender, por e ka mësuar pasi i ka gjetur atje. Nuk ka qenë në dijeni paraprakisht lidhur me ofertat e subjekteve të tjerë dhe se nuk ka folur me të pandehurin [...] për t’i përgatitur një kërkesë dhe subjektit “[...]”. Nga komisioni janë lexuar procesverbalet e subjekteve dhe aty ka marrë vesh të metat në dokumentacion të subjekteve të tjerë, të cilët nuk i ka ditur më parë. Pasi është shpallur subjekti i përfaqësuar prej tij fitues, është takuar dhe kanë pirë kafë ku kanë diskutuar rrethanat sesi ato ishin skualifikuar. Ka pasur para ditës së tenderit komunikime telefonike me të pandehurin [...], duke e pyetur se kur do të zhvillohej procedura, pasi nuk kishte marrë akoma njoftim. Ai i ka thënë se ishte në drejtorinë e burgjeve për të dorëzuar një procesverbal. I ka thënë presim këto ditë se kanë mbaruar furnizimet, prandaj ka mundësi të bëhet këto ditë tenderi. Më datë 04.06.2016 është nisur në Gjermani për pesëmbëdhjetë ditë dhe i ka dhënë [...] [...]lekë të reja për të kryer furnizime për llogari të subjektit të tij (“[...]” sh.p.k) ditën që nuk do të ishte në [...]. Gjithashtu i ka thënë se i kishte një detyrim [...]t, pasi nuk kishte mundur t’ia likujdonte se ishte e shtunë dhe nuk kishte banka. I ka thënë se nëse i dilte kjo shumë, t’ia jepte dhe atij këtë vlerë. E ka marrë në telefon [...]n duke i thënë që i kishte lënë dy milionë lekë [...]it dhe nëse atij i dilte vlera që i kishte lënë (pasi ia kishte lënë për të kryer furnizime), t’ia merrte atij vlerën që i detyrohej. Këtë detyrim prej [...] milionë e [...] mijë ia ka kaluar më datë 17 apo 18 nëpërmjet bankës [...] (pasi ishte kthyer nga [...]), detyrim ky i lindur pasi ai ([...]u) kishte marrë disa furnizime në mallra. Të pandehurin [...] e njeh si [...] të D.P.Burgjeve dhe e kishte takuar brenda ambjentëve të drejtorisë për

çështje pune. Me të pandehurin [...] ka një marrëdhënie më të afërt se me të pandehurit e tjerë, [...] dhe [...], për shkak se bënte shpesh furnizime tek ai (tek pika që kishte në autostradë), dhe për shkak të faktit se i kishin shtëpitë afër qëllonte shpesh të pinin kafen bashkë.”

13. Bashkëpandehurit të gjykuar më vete [...], i pyetur konform kërkesave të nenit 167 të K.Pr.Penale, në seancë gjyqësore ndër të tjera ka deklaruar se: “Me të pandehurin [...], për tre muajt e parë të marrëdhënies së tij të punës si Drejtor i Përgjithshëm të Burgjeve (në periudhën 07.10.2016-16.07.2016) ka pasur marrëdhënie normale pune. Nuk komunikoi ndërmjet tyre dhe kjo, për shkak se [...], si zëvendës drejtor i burgjeve ishte i papërgjegjshëm për funksionin që mbante. Ai as nuk hynte në zyrën e tij, gjatë kësaj periudhe dhe për pasojë as nuk i ka kërkuar atij të kryejë ndonjë aferë korruptive të lidhur me tenderin e datës 31.05.2016, apo dhe të kontaktojë me përfaqësues të operatorëve. Me të pandehurin [...], [...], [...], [...] nuk njihej më parë, nuk ka pasur kontakte apo takime me to dhe kjo, nuk fuste njeri në zyrë dhe në momentin që nënshkruhej kontrata nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, së parim firmosej nga e gjithë struktura, sektori logjistik, prokurimeve, juridik, thirrjet operatori fitues, nënshkruhej dhe në rrugë protokollare kontrata shkonte në zyrën e tij, ku dhe e nënshkruante, pasi verifikonte të gjithë firmat. Kështu që, dhe kontratën që e kam lidhur subjektin fitues të tenderit të datës 31.05.2016 nuk e ka njohur fizikisht dhe se nuk e ka lidhur në prezencë të personit. Lidhur me tenderin e datës 31.05.2016, [...] nuk ka qenë në asnjë prej komisioneve dhe nëse ai do të kishte dashur t’a angazhonte, t’a përfshinte në një aferë korruptive mund të urdhëronte që ai të ishte anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave. I vetmi moment i përfshirjes së nëndrejtorit [...] është nënshkrimi i një memoje të hartuar nga komisioni i përcaktimit të fondit limit, rrugë burokratike kjo, ku dhe ai ka marrë dijeni për procedurën.”

III. Vlerësimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në analizë të provave të shqyrtuara dhe të verifikuara në këtë proces (neni 152 i K. Pr.Penale), duke u mbështetur në tërësinë e provave dhe akteve të këtij gjykimi, konkludon se vlerësimi i saj juridik dhe fakteve është i njëjtë me konkluzionin e arritur nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me përjashtim të cilësimit juridik, për faktin penal, që lidhet me procedurën e tenderit datë 31.05.2016, kjo për vetë faktin se, personi, për të cilin i pandehuri [...] ka deklaruar që lekët i kam marrë për llogari të tij, i gjykuari më vehte [...] është deklaruar i pafajshëm me vendimin e formës së prerë nr.70 datë 19.09.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, i cili si ish Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, ka patur cilësinë e zyrtarit të lartë, cilësi të cilën nuk e ka patur zv. Drejtori i DPB, i pandehuri [...], por është një funksionar shtetëror, me statusin e nëpunësit civil, pra bie bashkëpunimi me zyrtarin e lartë, e në këto kushte konformë kërkesave të nenit 375/1 të K.Pr.Penale, duhet ndryshuar cilësimi juridik i veprës, nga “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror dhe të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 260 i K. Penal, në “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K. Penal. Në këtë mënyrë dhe për të pandehurit [...], [...], [...] e [...], në referim të nenit 375 të K.Pr.Penale, duhet ndryshuar cilësimi juridik i veprës penale nga “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror”, parashikuar nga neni 245 i K. Penal në “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i K. Penal. Në këtë rast jemi përpara një kualifikimi juridik më të favorshëm, meqenëse veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike parashikojnë marzhe dënimi më të lehta sesa veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore.

1. Kolegji i apelit, vlerëson se, me provat dhe akte të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë, si dhe ato që janë marrë në apel, rezulton se është provuar, përtej çdo dyshimi të arësyeshem se:

Së pari: I pandehuri [...] ka qenë me detyrë zv.drejtorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe gjatë ushtrimit të funksionit ka marrë shumën prej [...] lekë nga të i pandehuri

[...], sipas tij për tja dërguar Drejtorit të Përgjithëshëm të Burgjeve [...], shumë kjo e mbledhur nga të pandehurit [...], [...], [...] e [...], pasi më parë për një veprim të tillë kishin rënë në dakort mes tyre, kjo për shkak të favoreve që kanë patur nga DPB, për tenderin e drejtëpërdrejtë datë 31.05.2016, tender për të cilin është shpallur fitues subjektin e përfaqësuar nga i pandehuri [...] , “[...]”shpk, i cili ishte dhe subjekti, mbi ankimin e të cilit ishte anuluar e gjithë procedura me shpallje elektronike dhe për efekt të këtij anulimi lindte nevoja për zhvillimin e procedurës pa shpallje paraprake, ku subjektet e të pandehurve [...] , [...] e [...] do të ishin nënkontraktorë të firmës fituese, kjo e provuar me deklaratimet e të pandehurit [...] e deklaratimet e të pandehurit [...] dhënë në hetimet paraprake, si dhe në përgjimet telefonikë e vëzhgimet ambientale.

Me kryerjen e këtyre veprime të kundraligjëshe të pandehurit [...],[...], [...], [...] e [...]kanë konsumuar elementët e veprave penale;

a.I pandehuri [...] veprën penale, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.Penal.

b.Të pandehurit [...], [...], [...] e [...], “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 244 e 25 të K.Penal.

Së dyti: I pandehuri [...], gjatë përmbushjes së detyrës, për shkak të qënies së tij anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave ushqimore, në zbatim të kontratës nr. 7/5 datë 20.04.2016 “[...]”, ka kërkuar nga përfaqësuesi i subjektit “[...]”, i pandehuri [...], si dhe nga përfaqësuesi i subjektit “[...]”, i pandehuri [...], që luante rolin e furnizuesit të mallit për llogari të subjektit “[...]”, një përfitim të parregullt, një vlerë të caktuar monetare. Marrëveshjen për dhënie të këtij përfitimi të parregullt e ka arritur me të pandehurin [...] dhe ky i fundit ka arritur marrëveshjen me të pandehurin [...] që këtë përfitim të parregullt të pandehurit [...] duhet t’ia jepte i pandehuri [...], i cili dhe ia kishte dhënë të pandehurit [...], kjo e provuar me përgjimet telefonike, si dhe deklaratimet e të pandehurit [...] Kalaa dhënë në hetimet paraprake.

Me kryerjen e këtyre veprime të kundraligjëshe të pandehurit [...],[...], [...], [...] e [...]kanë konsumuar elementët e veprave penale;

a.I pandehuri [...]n veprën penale, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.Penal.

b.Të pandehurit [...], [...], [...] e [...], “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 244 e 25 të K.Penal.

Së treti: Për sa sipër, kjo gjykatë duke çmuar provat në tërësi e tyre, në kuptim të nenit 152/1 të K.Pr.Penale, konkludon se, jo vetëm që provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, që të pandehurit [...],[...], [...], [...] e [...], me veprimet e tyre në të dyja rastet janë përfshirë në aferën korruptive, por provohet që secili prej të pandehurve në bashkëpunim ndërmjet tyre në këto afera korruptive ka vepruar me faj me formën e dashjes direkte, duke parashikuar dhe dëshiruar pasojat, si dhe duke cënuar marrëdhënie të rëndësishme juridike, veprimtarinë e rregullt të administratës publike e funksionarëve të publik shtetërorë, shtetin ligjor, transparencën dhe drejtësinë shoqërore dhe konkurrencën.

Së katërti: Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e të pandehurit [...] me datë 11.07.2016 janë gjetur e sekuestruar sekuestruar, një [...],[...]të pagoditur; [...] në pjesën e markerimit [...]. Sipas akti i ekspertimit teknik nr.6405, datë 15.07.2016 kanë rezultuar se [...]janë të rregullt teknikisht dhe e përshtatshme për [...].

Në këto kushte i pandehuri [...], duke mbajtur armë dhe municione në banesë, pa lejen e organeve kompetente ka konsumuar elementët e veprës penale, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal.

2.Kolegji, vlerëson se, drejtë ka vepruar Gjykatë në shkallës së parë, përse i përket cilësimit ligjor të veprës dhe masës së dënimit, përcaktuar ndaj të pandehurve, lidhur me episodin për kolaudimin e mallrave që ka marrë [...], nga subjekti “[...]” shpk, sipas kontratës nr.7/5 datë 20.04.2016, ku ka bërë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës, pasi ka konkluduar që i pandehuri [...] gjatë ushtrimit të detyrës, nuk ka qënë zyrtar me funksion të lartë shtetëror, sipas parashikimeve të nenit 3 i ligjit nr.10034 datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së

funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve” dhe nenit 31 iligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, por ka qënë një funksionar shtetëror, me statusin e nëpunësit civil dhe për pasojë do të mbajë përgjegjësi penale, sikurse dhe të gjithë funksionarët/nëpunësit e tjerë që gëzojnë këtë status, sepse nuk përfshihen në funksionet e larta shtetërore. Në përfundim ajo gjykatëka dënuar të pandehurit pandehurin[...] me tre vjet burgim, për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.Penal, ndësa të pandehurit [...] e [...] i ka dënuar me nga një vit gjashtë muaj burgim secilin, për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunum, parashikuar nga nenet 244 e 25 të K.Penal.

3. Njëkohësisht kolegji vlerëson se, i drejtë ka qënë cilësimi ligjor dhe masa e dënimit përcaktuar nga gjykata në shkallë të parë, lidhur me armën dhe municionin gjetur në banesën e të pandehurit [...], ku ka dënuar të pandehurin [...] me një vit e gjashtë muaj burgim, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/3 i K. Penal, sepse i pandehuri [...], me dashje direkte ka cënuar marrëdhëniet shoqërore, të lidhura me rendin dhe sigurinë publike, kjo duke mbajtur pa leje të organeve kompetente armë luftarake e municion në banesë.

4. Kolegji, vlerëson se, i drejtë ka qënë vlerësimi i bërë nga gjykata në shkallë të parë, në lidhje me caktimin e masave të dënimit për veprat penale për të cilat janë dënuar, të pandehurit [...], [...], [...], [...] e [...], pasi është përshkruar rrezikshmëria shoqërore e veprave penale dhe e autorëve, rrethanat lehtësuese e rënduese, po kështu drejtë është vepruar nga ajo gjykatë në mënyrën e bashkimit të dënimeve, ku është përdorur sistemi i ashpërsimit. Po kështu i drejtë është disponimi i gjykatës në shkallë të parë, kur pas caktimit të dënimit, për të pandehurin [...] si bashkëpunëtori drejtësisë, në referim të neneve 37/a-4 e 37/b-dh të K.Pr.Penale, ka aplikuar uljen e masës së dënimit të dhënë për këtë pandehur, njëkohësisht i drejtë disponimku ajo gjykatë, në zbatim të neneve 30 pika 1 dhe 35/1 të K. Penal, ndaj të pandehurit [...] ka caktuar si dënim plotësues “Heqja e së drejtës për të kryer funksione publike”, për një afat prej pesë vite, afat që fillon pas vuajtjes së dënimit me burgim. Ndërkohë ky kolegji në ndryshim nga shkalla e parë, për të pandehurin [...] në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të K.Penal, çmon të aplikojë sitemin e thithjes, kjo për vetë faktin se, ky i pandehur nuk paraqet ndonjë rrezikshmëri të madhe shoqërore, pasi duke u nisur nga rrethanat e faktit rezulton se, përfshirja e tij në këtë veprimtari të kundraligjshme në të dyja rastet në një farë mënyre ka qënë e diktuar nga të tjerët.

5. Në ndryshim nga shkalla e parë, ky kolegji çmon se, për të pandehurin [...] duhet aplikuar neni 59 i K.Penal, duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit për pjesën e pavuajtur të tij, e i pandehuri të kalojë në shërbim prove, pasi plotësohen kushtet e nenit 59/1 të K.Pr penale, sepse i pandehuri është dënuar nën pesë vjet burgim si dhe për shkak të nevojave veçanërisht familjare të tij, ku në shtëpi ka dy persona të sëmurë, njëri nga të cilët ka nevojë për kujdesje familjare, kjo sepse:

a. Sipas çertifikatë familjare nr.390 datë 30.06.2018, rezulton se i pandehuri ka në familjen e tij nënën [...], [...] e [...]. Sipas raportit mjeko ligjor nr.1402 datë 29.05.2018 e përgjigjen rekomandim, rezulton që [...] është e sëmurë, po kështu sipas vlerësimit psikologjik nr.4278 datë 07.06.2018, rezulton që [...] është e sëmurë dhe ka nevojë për asistencën e një personi familjar. Në këto kushte kolegji vlerëson se, në rastin e familjes së pandehurit [...] jemi para nevojave veçanërisht familjare, pasi në familjen e tij ka dy persona të sëmurë, ku gruaja ka nevojë për asistencë familjare, dhe i vetmi person i aftë për përkujdesjen ndaj tyre është i pandehuri [...].

b. Këto rrethana familjare janë vlerësuar nga gjykatat në momentin e verifikimit të kushteve për zbatimin e masës së sigurimit, ku me vendimin nr.223, date 13.07.2016 Gjykata e

Shkallës së Parë për Krime të Rënda gjatë verifikuar të kushtet për zbatimin e masës së sigurimit “arrest ne burg”, ka caktuar si masë sigurimi “arrest në shtëpi”, ndërsa Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendim nr.92, date 30.07.2016, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë nr. 223, datë 13.07.2016, duke caktuar si masë sigurimi personal me karakter shtërngues ndaj të hetuarit [...] “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”.

c.Po kështu këto rrethana familjare ka patur parasysh dhe prokuroria në shkallë të parë, ku në diskutimin përfundimtar, bazuar në nenin 59 të K.Penal ka kërkuar pezullimi e ekzekutimit të vendimit për të pandehurin [...].

6.Ndërkohë për këtë kolegji i drejtë është disponimi i gjykatës së shkallës së parë, në lidhje me provat materiale, sekuestruar për llogari të këtij procedimi, pasi një disponim i tillë gjen zbatim në nenin 190 të K.Pr.Penale, si dhe disponimi për shpenzimet gjyqësore sespe ky disponim gjen zbatim në nenin 393 të K.Pr.Penale.

Në përfundim kolegji,në respektim të nenit 420/1-a,b të K.Pr.Penale konkludon si më poshtë:

A.Vendimi nr. 79 dt. 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, duhet lënë në fuqi, në lidhje me fajësinë, cilësimin juridik dhe dënimin e caktuar për të pandehurit:

1.[...] për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.Penal dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/3 i K.Penal.

2.[...] për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244 e 25 i K.Penal.

3.[...] për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244 e 25 i K.Penal.

B.Vendimit Nr. 79 dt. 12.07.2018 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duhet ndryshuar, lidhur me episodin e tenderit datë 31.05.2016, duke bërë një cilësim juridik të ndryshën me atë që, i ka dënuar Gjykata në Shkallë të parë të pandehurit, pasi i gjykuari më vehte,ish Drejtori i Përgjithëshëm i Burgjeve, i cili ka patur cilësin e zyrtarit të lartë,[...]është deklaruar i pafajshëm me vendimin e formës së prerë nr.70 datë 19.09.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, cilësi të cilën nuk e ka patur zv. Drejtori i DPB, i pandehuri [...], por është një funksionar shtetëror, me statusin e nëpunësit civil, e në këto kushte konformë kërkesave të nenit 375/1 të K.Pr.Penale, ndryshohet cilësimi juridik i vepërs, nga “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror dhe të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 260 i K.Penal, në “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.Penal.Njëkohësisht dhe për të pandehurit [...], [...], [...] e [...], në referim të nenit 375/1 të K.Pr.Penale, ndryshohet cilësimi juridik i veprës penale nga “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror”, parashikuar nga nenet 245 e 25 i K.Penal, në “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 e 25 i K.Penal, sepse në këtë rast jemi përpara një kualifikimi juridik më të favorshëm, meqenëse veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike parashikojnë marzhe dënimi më të lehta, sesa veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore.

Në kushtet kur bëhet ndryshimi i cilësimit juridik i veprës, për episodin e tenderit datë 31.05.2016, kolegji vlerëson se duhet të deklarohen fojtor, e të dënohen të pandehurit [...], [...], [...], [...] e [...]për veprat penale si më poshtë:

1.Ipandehurit [...] për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.Penal, duke u dënuar me tre vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të K.Penal, i pandehuri [...], të dënohet me një dënim të vetëm me pesë vjet burgim.

Në zbatim të neneve 37/a e 37/b shkronja dh,të K.Pr.Penale uljen e masës së dënimit, nga pesë vjet, në dyvjet e tetë muaj burgim.

2.I pandehuri [...]për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 244 e 25 të K.Penal,duke e dënuar me dy vjet e gjashtëmuaj burgim.

3.Deklarimin fajtor të të pandehurit [...] për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, i parashikuar nga neni 244 dhe 25 të K.Penal,duke e dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim.

Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit [...] me një dënim të vetëm me dy vjet e gjashtë muaj burgim.

4.I pandehuri [...] për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 244 e 25 të K.Penal duke e dënuar me dy vjet burgim.

5.I pandehuri [...] për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, i parashikuar nga neni 244 e 25 të K.Penal duke dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim.

Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit [...] me një dënim të vetëm me dy vjet e gjashtë muaj burgim.

Në aplikim të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit të mësipërm duke urdhëruar të dënuarin [...] të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, Zyra Vendore Tiranë për një periudhë me dy vjet, me kusht, që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Në zbatim të nenit 60/a të K.Penal urdhërohet i pandehuri [...] të mos shoqërohet me bashkëpunëtorët e veprës penale.

C. Po kështu, ashtu siç është cituar më sipër vendimi nr. 79 dt. 12.07.2018 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duhet lënë në fuqi pjesët e tjera të tij.

Lidhur me shpenzimet procedurale të kryera gjatë gjykimit në apel, kolegji çmon se, ato duhet tu ngarkohen të pandehurve solidarisht, kjo në referim të nenit 393 të K.Pr.Penale.

Lidhur me pretendimin e të pandehurve e mbrojtësve të paraqitura në ankim dhe gjatë gjykimit në apel, për ndreqjen e pasojave për gjykimin e shkurtuar, kolegji vlerëson se, kjo kërkesë nuk duhet pranuar, pasi vetë mbrojtësit dhe të pandehurit gjatë gjykimit në aplel investuan gjykatën për marrjen e një prove të re, nëpërmes përsëritjes së pjesëshme të shqyrtimit gjyqësor, kjo në kuptim të nenit 427/1,2 të K.Pr.Penale.

Lidhur me pretendimet e paraqitura nga mbrojtësit dhe të pandehurit në ankim dhe gjatë gjykimit në apel, ku ato kërkuar që të pandehurit,duhet të deklarohen të pafajshëm,pasi nuk provohet të kenë kryer veprat penale për të cilën janë akuzuar, kolegji, ashtu siç katrajtuar më sipër vlerëson se, është provuar përtej çdo dyshimi të arësyeshem që të pandehurit i kanë konsumuar veprat penale, për të cilat ky kolegji ushpreh që ato të dënohen.

Lidhur me kërkesën e prokurorit në apel, i cili kërkoi që të lihet ne fuqi vendimi nr.79 dt. 12.07.2018 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, kolegji ashtu siç ka argumentuar më sipër vlerëson se,kërkimi nuk duhet pranuar tërësisht, pasi vendimi duhet ndryshuar për episodin lidhur me tenderit datë 31.05.2016, meqënëse më vendim të formës së prerë është deklaruar i pafajshëm zyrtari i lartë, duke u lënë në fuqi për pjesët e tjera të tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, bazuar në nenet 428/1-a,b të K.Pr.Penale:

VENDOSI

A. Lënien në fuqi të vendimit Nr. 79 dt. 12.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në lidhje me fajësinë, cilësimin juridik dhe dënimin e caktuar për të pandehurit:

1. I.L. për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.Penal dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/3 i K.Penal.

2. Sh.S. për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244 e 25 i K.Penal.

3. Y.K. për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244 e 25 i K.Penal.

B. Ndryshimin e vendimit Nr. 79 dt. 12.07.2018 të Gjykatës për Krime të Rënda, si më poshtë:

1. Deklarimin fajtor e të pandehurit I.L. për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit I.L. me një dënim të vetëm me 5 (pesë) vjet burgim.

Në zbatim të neneve 37/a e 37/b – gërma “dh” të K.Pr.Penale uljen e masës së dënimit, nga 5 (pesë) vjet, në 2 (dy) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit E.L. për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244 dhe 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Sh.S. për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, i parashikuar nga neni 244 dhe 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Sh.S. me një dënim të vetëm me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

4. Deklarimin fajtor të të pandehurit N.B. për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, i parashikuar nga neni 244 dhe 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

5. Deklarimin fajtor të të pandehurit Y.K. për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, i parashikuar nga neni 244 dhe 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Y.K. me një dënim të vetëm me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Në aplikim të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit të mësipërm duke urdhëruar të dënuarin Y.K. të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, Zyra Vendore Tiranë për një periudhë me 2 (dy) vjet, me kusht, që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.

Në zbatim të nenit 60/a të K.Penal urdhërohet i pandehuri Y.K. të mos shoqërohet me bashkëpunëtorët e veprës penale.

C. Lënien në fuqi të këtij vendimi, në pjesët e tjera të tij.

D. Shpenzimet procedurale edhe në këtë shkallë gjykimi i ngarkohen të pandehurve solidarisht.

Tiranë më 23.11.2018

Anëtar
Fehmi Petku

Anëtare
Albana Boksi

Kryesues
Idriz Mulkurti